

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: : **KUVENDI KOMUNAL MITROVICË**

Nr i Prokurimit **642-26-4255-5-2-1**

Sa i përket tenderit për **Rregullimi i Qendrës së Kulturës Aneksi A&B LLOT 1**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

HAJRUSH J.SHOSHI BI-UNIKU& INTERING CONSTRUCTION & NNP''CTA''shpk

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

8MAJI NR166 ISTOG

(Adresa)

ISTOG

31000.

(Vendi)

(Kodi postar)

+38343903333

(Numri Telefonit)

(Numri)

HAJRUSH SHOSHI

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

mendurims@gmail.com

(Adresa elektronike)

10.09.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Aktiviteti i prokurimit është zhvilluar nga **Autoriteti Kontraktues – Kuvendi Komunal Mitrovicë**, përmes **procedurës së hapur**, me nr. të prokurimit **642-26-4255-5-2-1**, për aktivitetin me titull **“Rregullimi i Qendrës së Kulturës Aneksi A&B (LLOT 1)”**. Dosja e Tenderit e korrigjuar mban versionin e datës **15.06.2026**.

Njoftimi për Kontratë është publikuar me datën 05.06.2026.

Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve ka qenë me datën **26.06.2026, në ora 12:00**, ndërsa hapja e tenderëve është zhvilluar po me datën **26.06.2026, në ora 12:00**, përmes platformës elektronike **E-Prokurimi**. Këto të dhëna përcaktohen edhe në Fletën e të Dhënave të Tenderit dhe konfirmohen në Procesverbalin e Hapjes së Tenderëve.

Sipas Dosjes së Tenderit, **kriteri për dhënie të kontratës ka qenë “Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët”**. Kjo do të thotë se për dhënien e kontratës fillimisht tenderi duhet të jetë i përgjegjshëm dhe, ndërmjet tenderëve të përgjegjshëm, kontrata i jepet tenderit me çmimin më të ulët.

Pas përfundimit të procesit të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, Autoriteti Kontraktues me datën **27.08.2026** ka publikuar **Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues**, me të cilin për **LLOT 1** është rekomanduar për dhënie të

kontratës operatori ekonomik **AGE GROUP SH.P.K.**, me çmim total të ofertës prej **274,418.00 €**.

Në të njëjtin LLOT, **IDEALI COMPANY SH.P.K.** ka ofertuar me çmim prej **249,249.00 €**, ndërsa **GOE Hajrush J. Shoshi B.I.; NNP CTA SH.P.K.; INTERING CONSTRUCTION SH.P.K.** ka ofertuar me çmim prej **253,065.50 €**. Oferta e GOE-së sonë është vlerësuar nga Autoriteti Kontraktues si e papërgjegjshme.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Hapja është bërë në platformën e prokurimit

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Me datën **01.09.2026**, në kuadër të aktivitetit të prokurimit me titull **“Rregullimi i Qendrës së Kulturës Aneksi A&B (LLOT 1)”**, me nr. të prokurimit **642-26-4255-5-2-1**, kemi parashtruar pranë Autoritetit Kontraktues **Kërkesë për Rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 27.08.2026**, përmes të cilit Grupi ynë i Operatorëve Ekonomikë është shpallur i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga procedura e mëtejshme e prokurimit.

Në Kërkesën për Rishqyrtim kemi kundërshtuar arsyet e eliminimit tonë, si dhe mënyrën e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, duke paraqitur faktet, argumentet dhe provat përkatëse në mbështetje të pretendimeve tona ankimore. Pas qasjes në dokumentacionin e aktivitetit të prokurimit, kemi evidentuar edhe shkelje dhe parregullsi të tjera që konsiderojmë se kanë ndikuar në rezultatin përfundimtar të procedurës.

Autoriteti Kontraktues, pas shqyrtimit të Kërkesës sonë për Rishqyrtim, me datën **04.09.2026** ka nxjerrë Vendim me të cilin **Kërkesën tonë për Rishqyrtim e ka refuzuar si të pabazuar** dhe ka lënë në fuqi Njoftimin mbi Vendimin e datës **27.08.2026**.

Duke konsideruar se Vendimi i Autoritetit Kontraktues nuk i ka trajtuar drejt dhe në mënyrë të plotë pretendimet, faktet dhe provat e paraqitura nga ana jonë dhe se eliminimi ynë është bërë në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe dispozitat përkatëse

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK gjate vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve nuk ka zbatuar me përpikëri të gjitha dispozitat e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Përpos kësaj AK nuk ka respektuar as kërkesat e dosjes së tenderit të cilat vetë i ka parashtruar në fillim të këtij procesi të prokurimit. Dispozitat që ne mendojmë se AK i ka shkelur janë:

LPP:

- Neni 1
- Neni 11.3
- Neni 11.4
- Neni 56 / 56.1.1
- Neni 59 / 59.4
- Neni 68 / 68.1.5 / 68.3
- Neni 69 / 69.6.2 / 69.6.3 / 69.8
- Neni 71, paragrafi 4
- Neni 72 / 72.1 / 72.3

Rregullorja për Prokurimin Publik:

- Neni 7.6.1
- Neni 38 / 38.3 / 38.6
- Neni 40 / 40.2 / 40.6

**** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.**

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me datë **27.08.2026**, Autoriteti Kontraktues – **Komuna e Mitrovicës Jugore**, në kuadër të aktivitetit të prokurimit me nr. **642-26-4255-5-2-1**, me titull “**Rregullimi i Qendrës së Kulturës Aneksi A&B (LLOT 1)**”, ka lëshuar Letrat Standarde për tenderuesit e papërgjegjshëm, përmes të cilave operatorët ekonomikë janë njoftuar lidhur me rezultatin e ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave.

Sipas **Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues**, për **LLOT 1** është rekomanduar për dhënie të kontratës operatori ekonomik **AGE GROUP SH.P.K.**, me çmim total të ofertës prej **274,418.00 €**. Në të njëjtin LLOT, **IDEALI COMPANY SH.P.K.** ka ofertuar me çmim prej **249,249.00 €**, ndërsa **GOE Hajrush J. Shoshi B.I.; NNP CTA SH.P.K.; INTERING CONSTRUCTION SH.P.K.** ka ofertuar me çmim prej **253,065.50 €**.

Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar si të papërgjegjshme ofertën e **GOE Hajrush J. Shoshi B.I.; NNP CTA SH.P.K.; INTERING CONSTRUCTION SH.P.K.**, duke e arsyetuar eliminimin, ndër të tjera, me pretendimin për mosplotësimin e kriterit lidhur me kontratat e realizuara të natyrës së ngjashme, përkatësisht kërkesën që Lideri i konzorciumit të dëshmojë së paku **60% të vlerës së kërkuar të kontratave të realizuara**, si dhe me çështjet lidhur me dokumentacionin për gjendjen ekonomike dhe financiare.

Po ashtu, Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar si të papërgjegjshme ofertën e **IDEALI COMPANY SH.P.K.**, për arsye që lidhen me përmbushjen e kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional, personelin dhe pajisjet e kërkuara sipas Dosjes së Tenderit.

Me datë **28.08.2026**, **GOE Hajrush J. Shoshi B.I.; NNP CTA SH.P.K.; INTERING CONSTRUCTION SH.P.K.** ka parashtruar kërkesë për **qasje në dokumentacionin e aktivitetit të prokurimit për LLOT 1**, me qëllim të verifikimit të procesit të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave. Autoriteti Kontraktues na ka mundësuar qasjen me datë **31.08.2026**.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, me datë **01.09.2026** kemi parashtruar **Kërkesë për Rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 27.08.2026**, duke kundërshtuar si arsyet e eliminimit të **GOE**-së sonë, ashtu edhe mënyrën e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave të operatorëve të tjerë.

Autoriteti Kontraktues, me datë **04.09.2026**, ka nxjerrë Vendim me të cilin **Kërkesën tonë për Rishqyrtim e ka refuzuar si të pabazuar** dhe ka vendosur të vazhdojë me Njoftimin mbi Vendimin e datës 27.08.2026.

Konsiderojmë se Vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës **04.09.2026** nuk i ka trajtuar dhe vlerësuar drejt dhe në mënyrë të plotë pretendimet, faktet dhe provat e paraqitura nga ana jonë, ndërsa vlerësimi i ofertave përmban shkelje dhe parregullsi që kanë ndikuar në rezultatin përfundimtar të aktivitetit të prokurimit.

Për këto arsye, në vijim paraqesim pretendimet tona ankimore, faktet, argumentet dhe

provat në mbështetje të kësaj Ankese drejtuar Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).

Pretendimi ankimor nr. 22

Mosrespektimi nga Autoriteti Kontraktues i afatit ligjor për nxjerrjen dhe publikimin e Vendimit mbi Kërkesën për Rishqyrtim

GOE Hajrush J. Shoshi B.I.; NNP CTA SH.P.K.; INTERING CONSTRUCTION SH.P.K., me datën **01.09.2026**, ka parashtruar përmes sistemit të prokurimit elektronik Kërkesë për Rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 27.08.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Rregullimi i Qendrës së Kulturës Aneksi A&B (LLOT 1)”**, me nr. të prokurimit **642-26-4255-5-2-1**.

Sipas **nenit 108/A paragrafi 6 të LPP-së**, Autoriteti Kontraktues është i obliguar ta shqyrtojë Kërkesën për Rishqyrtim brenda **tre (3) ditëve të punës** nga data e dorëzimit të saj. Ky afat mund të zgjatet, në raste specifike dhe të justifikuara, për jo më shumë se tri ditë shtesë, me kusht që ankuesi të informohet për zgjatjen. Të njëjtin detyrim e përcakton edhe **neni 61.3 i Rregullores për Prokurimin Publik**.

Në rastin konkret, afati është llogaritur si vijon:

- **01.09.2026** – dita e parashtrimit;
- **02.09.2026** – dita e parë e punës;
- **03.09.2026** – dita e dytë e punës;
- **04.09.2026** – dita e tretë dhe e fundit e punës.

Sipas **nenit 5 të LPP-së**, afatet kohore të përcaktuara me ligj përfundojnë **në ora 16:00 në ditën e skadimit**. KRPP gjithashtu e ka konfirmuar në interpretimet e veta se afatet e LPP-së i nënshtrohen këtij kufiri kohor.

Megjithatë, nga sistemi elektronik i prokurimit rezulton se Vendimi i Autoritetit Kontraktues mbi Kërkesën për Rishqyrtim është publikuar me datën **04.09.2026 në ora 16:08**, pra **pas orës 16:00**, kur afati ligjor prej tri ditësh pune tashmë kishte skaduar.

Rrjedhimisht, edhe pse Vendimi mban datën 04.09.2026, publikimi i tij në sistem është bërë

8 minuta pas përfundimit të afatit ligjor.

Kjo është relevante edhe sepse, sipas interpretimit të KRPP-së, “Vendimi i lëshuar” në procedurën e rishqyrtimit nënkupton **Vendimin e publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik**, ndërsa operatorët ekonomikë konsiderohen të njoftuar nga momenti i publikimit të tij në sistem.

Deri në ora **16:00 të datës 04.09.2026**, ankuesi nuk kishte pranuar vendim meritore mbi Kërkesën për Rishqyrtim dhe, sipas dokumentacionit që kemi në dispozicion, nuk ishte njoftuar as për ndonjë zgjatje të afatit sipas nenit 108/A.6 të LPP-së.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me **nenin 5 dhe nenin 108/A paragrafi 6 të LPP-së**, si dhe me **nenin 61.3 të Rregullores për Prokurimin Publik**, duke publikuar vendimin pas skadimit të afatit ligjor.

Për këtë pretendim kërkojmë nga OSHP-ja që të konstatojë mosrespektimin e afatit ligjor nga Autoriteti Kontraktues, duke marrë parasysh se **Vendimi është publikuar më 04.09.2026 në ora 16:08, pra pas orës 16:00 të ditës së fundit të afatit, dhe të vazhdojë me shqyrtimin meritore të Vendimit dhe të të gjitha pretendimeve të tjera ankimore të GOE-së.**

PRETENDIMET NDAJ OE IDEALI COMPANY SH.P.K.

Pretendimi Nr. 1

– AK me të drejtë ka konstatuar mospërbushjen e Kërkesës nr. 3 nga OE IDEALI COMPANY SH.P.K.

Autoriteti Kontraktues, gjatë vlerësimit të ofertës së OE **IDEALI COMPANY SH.P.K.**, me të drejtë ka konstatuar se ky operator ekonomik nuk ka përmbushur kërkesën e përcaktuar në Dosjen e Tenderit lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional, konkretisht **Kërkesën nr. 3 – Inxhinieri i Elektroteknikës.**

Në Dosjen e Tenderit, në kuadër të kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional, është përcaktuar:

“Një (1) Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës ose Master – drejtimi energjetikë, me përvojë pune minimum 3 vite pas diplomimit; i licencuar nga OIRK.” Kjo kërkesë është përcaktuar të vlejë për të dy lotet.

Për dëshmimin e kësaj kërkeje, OE ka qenë i obliguar të paraqesë diplomën, licencën, kontratën apo parakontratën dhe CV-në, referencat ose vërtetimet për përvojën e punës.

Nga dokumentacioni i paraqitur nga **IDEALI COMPANY SH.P.K.** rezulton se personi i propozuar, Malush Musliu, është inxhinier i diplomuar i elektroteknikës, mirëpo në dokumentacionin e tij profesional, përfshirë edhe licencën e paraqitur, drejtimi i tij figuron **“Elektronikë”, dhe jo “Energjetikë”.**

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktues në njoftimin mbi vendimin ka konstatuar se, ndonëse personi i propozuar posedon kualifikim në fushën e elektroteknikës, **drejtimi/profili i tij nuk përputhet me drejtimin/profilin e kërkuar në Dosjen e Tenderit, dhe rrjedhimisht**

dokumentacioni i paraqitur nuk është konsideruar si përmbushje e Kërkesës nr. 3.

Vlerësojmë se ky konstatim i Autoritetit Kontraktues është i drejtë, pasi kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit duhet të zbatohen në mënyrë të njëjtë ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë dhe nuk mund të konsiderohet se një profil tjetër profesional, konkretisht **Elektronika**, është automatikisht i barasvlershëm me profilin **Energjetikë**, pa qenë një barasvlerë e tillë e paraparë në Dosjen e Tenderit ose e dëshmuar përmes dokumentacionit përkatës.

Pranimi i një profili tjetër nga ai i kërkuar do të nënkuptonte ndryshim ose zgjerim të kriterit pas afatit për dorëzimin e ofertave dhe do t'i vendoste operatorët ekonomikë që kanë respektuar kërkesën konkrete të DT-së në pozitë të pabarabartë.

Për më tepër, vetë Dosja e Tenderit përcakton se operatorët ekonomikë duhet t'i plotësojnë kërkesat minimale mbi mundësitë teknike dhe profesionale dhe duhet të dorëzojnë dokumentet dëshmuuese të përcaktuara në FDT. Po ashtu, tenderi konsiderohet i përgjegjshëm vetëm kur është në pajtueshmëri me kërkesat dhe specifikimet e DT-së dhe kur operatori përmbush kriteret e përzgjedhjes.

Prandaj, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues ta mbajë në fuqi konstatimin se OE IDEALI COMPANY SH.P.K. nuk ka përmbushur Kërkesën nr. 3 të Dosjes së Tenderit dhe se oferta e tij, në këtë aspekt, është trajtuar me të drejtë si e papërgjegjshme.

Pretendimi Nr. 2

OE IDEALI COMPANY SH.P.K. nuk e ka përmbushur Kërkesën nr. 5 të Dosjes së Tenderit lidhur me Inxhinierin e Hidroteknikës dhe certifikatën e trajnimit për sistemet e ngrohjes dhe ftohjes

Autoriteti Kontraktues, në kuadër të kërkesave për kapacitetin teknik dhe profesional, në **Kërkesën nr. 5** ka përcaktuar:

“Një (1) Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master – drejtimi Hidroteknikë, me përvojë pune minimum 5 vite pas diplomimit, i trajnuar për sistemet e ngrohjes dhe ftohjes duke përfshirë teknologjinë e kontrollit; I Licencuar nga OIRK (Kërkesa vlen për të dyja LLOTET).”

Për dëshmimin e kësaj kërkesë, AK ka kërkuar shprehimisht, ndër të tjera, **Diplomën, Licencën dhe Certifikatën**, si dhe kontratën apo parakontratën dhe dokumentet për dëshmimin e përvojës së punës.

Pra, nga përmbajtja e Dosjes së Tenderit rezulton qartë se nuk ka qenë e mjaftueshme vetëm paraqitja e një inxhinieri me kualifikim në fushën e hidroteknikës. Personi i propozuar është dashur të dëshmojë gjithashtu se është **i trajnuar për sistemet e ngrohjes dhe ftohjes, duke përfshirë teknologjinë e kontrollit**, dhe kjo është dashur të dëshmohet me **certifikatën përkatëse**.

Nga shqyrtimi i ofertës së **OE IDEALI COMPANY SH.P.K.**, Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se inxhinieri i hidroteknikës i paraqitur nga ky operator **nuk ka paraqitur certifikatën e trajnimit të kërkuar për sistemet e ngrohjes dhe ftohjes, duke përfshirë teknologjinë e kontrollit**. Ky konstatim është dhënë shprehimisht në njoftimin mbi vendimin e

AK-së.

Në këtë rast bëhet fjalë për mungesë të një dëshmie dokumentare që është kërkuar në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë në Dosjen e Tenderit. Fjala **“Certifikata”** është përfshirë shprehimisht në Dëshminë nr. 5 dhe lidhet drejtpërdrejt me kushtin që inxhinieri të jetë i trajnuar për sistemet e ngrohjes dhe ftohjes, përfshirë teknologjinë e kontrollit.

Për rrjedhojë, mungesa e kësaj certifikate nuk mund të trajtohet si një mangësi formale pa rëndësi, pasi ajo përbën dokumentin me të cilin duhej të dëshmohej një element i veçantë i kapacitetit profesional të personit të propozuar.

Autoriteti Kontraktues, në përmbledhjen e arsyeve për refuzimin e ofertës së IDEALI COMPANY SH.P.K., ka përsëritur se **“Inxhinieri i hidroteknikës i prezentuar nuk ka paraqitur certifikatën e kërkuar të trajnimit për sistemet e ngrohjes dhe ftohjes, duke përfshirë teknologjinë e kontrollit”** dhe mbi këtë bazë ka konstatuar mospërbushjen e Kërkesës nr. 5.

Përfundimisht, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues me të drejtë ka konstatuar se OE IDEALI COMPANY SH.P.K. nuk e ka përmbushur Kërkesën nr. 5 të Dosjes së Tenderit, pasi për inxhinierin e propozuar nuk është paraqitur certifikata e detyrueshme e trajnimit për sistemet e ngrohjes dhe ftohjes, përfshirë teknologjinë e kontrollit. Prandaj, kërkojmë që ky konstatim i AK-së dhe trajtimi i ofertës së këtij operatori si e papërgjegjshme të mbeten në fuqi.

Pretendimi Nr. 3

OE IDEALI COMPANY SH.P.K. nuk e ka përmbushur Kërkesën nr. 8 dhe Aneksin nr. 7 – Lista e Pajisjeve, lidhur me kamerën inspektuese për tuba të kanalizimit.

Autoriteti Kontraktues, në kuadër të kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional, në **Kërkesën nr. 8** ka përcaktuar se Operatori Ekonomik duhet të posedojë listën e pajisjeve, mjeteve dhe stabilimenteve që ka në dispozicion për realizimin e projektit, sipas **Aneksit nr. 7 – Lista e Pajisjeve**.

Në **Dëshminë nr. 8**, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar mënyrën e dëshmimit të pajisjeve. Pajisjet që regjistrohen duhet të dëshmohen me librezë valide të regjistrimit, ndërsa pajisjet që nuk regjistrohen duhet të dëshmohen me dokument për pronësinë, përkatësisht **faturë ose DUD**. Në rast se OE nuk e posedon pajisjen në pronësi, është kërkuar **marrëveshje për marrjen me qira**, e lidhur për këtë projekt dhe me validitet për kohëzgjatjen e kontratës.

Në kuadër të **Aneksit nr. 7** është kërkuar, ndër të tjera, pajisja:

“Kamerë inspektuese për tuba të kanalizimit, 23 mm, me kabllo 30 m.”

Autoriteti Kontraktues, gjatë vlerësimit të ofertës së OE IDEALI COMPANY SH.P.K., ka konstatuar se nga dokumentacioni i dorëzuar **nuk rezulton se ky OE posedon dhe/ose ka deklaruar pajisjen e specifikuar**, përkatësisht kamerën inspektuese për tuba të kanalizimit me diametër **23 mm** dhe kabllo me gjatësi **30 m**.

Po ashtu, Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se kjo pajisje është kërkuar në mënyrë të qartë dhe specifike në Dosjen e Tenderit dhe se **kërkesa vlen për të dy lotet**.

Në këtë rast **nuk kemi të bëjmë me një mangësi thjesht formale**, por me **mospërbushje të një kriteri të kapacitetit teknik**, pasi Operatori Ekonomik ka qenë i obliguar jo vetëm ta deklarojë pajisjen e kërkuar, por edhe ta dëshmojë posedimin ose sigurimin e saj në mënyrën e përcaktuar në **Dëshminë nr. 8**.

Pajisja është përcaktuar me karakteristika konkrete teknike, përkatësisht **kamerë inspektuese për tuba të kanalizimit, 23 mm, me kabllo 30 m**. Prandaj, Operatori Ekonomik ka pasur për obligim të paraqesë pajisjen që plotëson këto karakteristika dhe dokumentacionin përkatës që dëshmon pronësinë ose marrjen me qira të saj.

Pranimi i një operatori ekonomik i cili **nuk ka paraqitur një pajisje të kërkuar shprehimisht në Aneksin nr. 7** do të nënkuptonte moszbatim të kriterit të njëjtë ndaj të gjithë ofertuesve dhe do t'i vendoste në pozitë të pabarabartë operatorët ekonomikë të cilët kanë siguruar dhe dëshmuar të gjitha pajisjet sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Përfundimisht, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues me të drejtë ka konstatuar se OE IDEALI COMPANY SH.P.K. nuk e ka përmbushur Kërkesën nr. 8 dhe Aneksin nr. 7 – Lista e Pajisjeve, pasi nuk ka paraqitur dhe dëshmuar pajisjen e detyrueshme “Kamerë inspektuese për tuba të kanalizimit, 23 mm, me kabllo 30 m”. Për këtë arsye, kërkojmë që konstatimi i Autoritetit Kontraktues dhe trajtimi i ofertës së këtij operatori si e papërgjegjshme të mbeten në fuqi.

Pretendimi Nr. 4

AK NUK E KA EVIDENTUAR GJATË VLERËSIMIT MOSPËRMBUSHJEN E KËRKESËS PËR “KAMIONETË ME VINÇ – PESHA E NGARKESËS DERI NË 600 KG”, NDËRSA DOKUMENTACIONI I OE IDEALI COMPANY SH.P.K. TREGON SE KJO KËRKESË NUK ËSHTË PËRMBUSHUR.

Autoriteti Kontraktues, në **Aneksin nr. 7 – Lista e Pajisjeve**, për **LOT 1** ka kërkuar në mënyrë të qartë:

“Kamionetë me vinç, pesha e ngarkesës deri në 600 kg” – 1 copë, me regjistrim valid.

Gjithashtu, sipas **Kërkesës nr. 8 dhe Dëshmisë nr. 8**, OE ka qenë i obliguar që për pajisjet e ofruara të paraqesë dokumentacionin përkatës dhe të japë **karakteristikat, specifikat teknike dhe kapacitetin e secilës pajisje**, në mënyrë që përmbushja e kërkesave të mund të verifikohet objektivisht.

OE **IDEALI COMPANY SH.P.K.**, për këtë pozicion, ka paraqitur një kamionetë me vinç në bazë të **Marrëveshjes për Shfrytëzim të Makinerisë me GIMI METAL SH.P.K.**

Mirëpo, nga **Certifikata e Regjistrimit** e automjetit të paraqitur nga OE, te rubrika përkatëse figuron vlera **824 kg**, ndërsa kërkesa e Autoritetit Kontraktues ka qenë **deri në 600 kg**.

Pra, ekziston një **mospërputhje konkrete dhe e verifikueshme ndërmjet kërkesës së AK-së dhe dokumentacionit të OE-së**:

Kërkesa e AK-së: deri në 600 kg

Dokumentacioni i OE IDEALI COMPANY SH.P.K.: 824 kg

Rrjedhimisht, vlera **824 kg tejkalon kufirin maksimal prej 600 kg të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues dhe, për pasojë, pajisja e paraqitur nuk dëshmon përmbushjen e karakteristikës teknike të kërkuar në Aneksin nr. 7.**

A	Numer i regjistrimit; Ipri registoringit; Registration number;	04-851-JG
I	Data e regjistrimit; Datum registoringit; Date of registration;	07.03.2022
C	Të dhëna personale; Lerimi personal; Personal data;	
C.2	Procesi i tij; Pajisja e tij; Owner of the vehicle;	
C.2.1	Mbështetësi i tij; Pajisja e tij; Supporter of the vehicle;	Gimi Metal SH.P.K.
C.2.2	Emri; Imeri; Name;	
C.2.3	Adresa; Adresa; Address;	Imer Krasniqi, pr. Malistovë
B	Data e regjistrimit të parë; Datum e parë registoringit; Date of first registration;	02.07.2003
D	Automjeti; Bashkë; Vehicle;	
D.1	Produksi; Prodhuesi; Make;	Ford
D.2	Tipi; Tari; Type;	FMDY
D3	Përshkrimet kontraktuale; Kontraktuale shprehje; Contractual description;	TRANSIT
E	Numeri identifikues i automjetit; Identifikuesi i automjetit; Vehicle identification number;	DA XXGBFA3LBZ355
S	Vlera e prodhimit; Vlera e prodhimit; Year of production;	2003
S.1	Kapaciteti i ulësve; Kapaciteti i ulësve; Seat capacity;	3
S.2	Numeri i vendëve për qëndrim; Epoqë e vendëve për qëndrim; Number of standing places;	
Q	Raporti Peshë/Potencial (kg/kW); Raporti Peshë/Potencial (kg/kW); Power/Weight ratio (kg/kW);	
F	Vlera e masës; Vlera e masës; Mass;	3490
F1	Vlera maksimale e peshës së lehtë; Peshë maksimale e lehtë; Maximum permitted laden mass;	824
G	Peshë e masës; Peshë e masës; Mass of the vehicle;	2675
K	Homologimi; Kontraktuale; Type of approval;	
P	Motori; Motori; Engine;	
P1	Kapaciteti i motorit; Kapaciteti i motorit; Capacity (ccm);	2402
P2	Paga maksimale e motorit (kW); Paga maksimale e motorit (kW); Maximum net power (kW);	92.00
P3	Tipi i motorit; Tipi i motorit; Type of motor;	Dizel
R	DA - E SARCHILLO	
2A	Niveli i motorit; Niveli i motorit; Level of the motor;	Kamionetë me vlerë më 2 dyer
	Shënimi; Shënimi; Mark;	Gimi Metal

Pavarësisht kësaj mospërputhjeje, Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit të ofertës së OE IDEALI COMPANY SH.P.K. nuk e ka evidentuar këtë mangësi si arsye shtesë të papërgjegjshmërisë së ofertës. Në vendimin e AK-së, sa i përket Aneksit nr. 7, është evidentuar mospërmbushja lidhur me kamerën inspektuese, por nuk është trajtuar edhe mospërputhja e kamionetës me vinq.

Konsiderojmë se vlerësimi i AK-së në këtë pjesë është jo i plotë, pasi Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar të verifikojë të gjitha pajisjet dhe karakteristikat teknike të kërkuara në Aneksin nr. 7 dhe jo vetëm një pjesë të tyre.

KËRKESË NDAJ AUTORITETIT KONTRAKTUES

Duke u bazuar në faktet dhe provat e paraqitura në këtë pretendim, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që PRETENDIMIN TONË NR. 4 TA APROVOJË SI TË BAZUAR.

Pretendimi Nr. 5

AK pa bazë ka trajtuar si sekret afarist Raportin e Auditimit dhe Deklaratat Tatimore Vjetore të OE IDEALI COMPANY SH.P.K., ndërsa nga dokumentacioni i dorëzuar nuk rezulton se ky operator ka paraqitur kërkesë për sekret afarist sipas Aneksit nr. 3 të Dosjes së Tenderit.

Autoriteti Kontraktues, gjatë lejimit të qasjes në dokumentacionin e ofertës së **OE IDEALI COMPANY SH.P.K.**, nuk na ka vënë në dispozicion **Raportin e Auditimit dhe Deklaratat Tatimore Vjetore**, duke i trajtuar këto dokumente si **sekret afarist**.

Mirëpo, nga shqyrtimi i **Formularit të Dorëzimit të Tenderit** të OE IDEALI COMPANY SH.P.K. rezulton se në listën e dokumenteve mbështetëse figurojnë shprehimisht:

Dokumenti nr. 4 – “Deklaratat Tatimore 23-24-25.pdf”, dhe
Dokumenti nr. 5 – “Raporti i auditimit per vitin 25-24-23-22.pdf”.

Në të njëjtën listë të dokumenteve të dorëzuara **nuk figuron Aneksi nr. 3 – Kërkesa për Sekret Afarist dhe as ndonjë dokument tjetër me të cilin OE IDEALI COMPANY SH.P.K. ka kërkuar që Raporti i Auditimit apo Deklaratat Tatimore të klasifikohen si sekret afarist.**

Kulturës, Palestrën Sportive dhe në Muzeun e Qytetit (LLOT 2)

- 1 Rregullimi i Qendrës së Kulturës Aneksi A&B (LLOT 1)
- 2 Rregullimi i nyjeve sanitare në Qendrën e Kulturës, Palestrën Sportive dhe në Muzeun e Qytetit (LLOT 2)

Kodi i tenderit: 1010

Data: 26.06.2026

Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse

Nr.	Dokument
1.	1 Certifikata e biznesit.pdf
2.	2 Certifikata e TVSH-se IDEALI COMPANY SHPK.pdf
3.	3 Deklarata Nen Betim.pdf
4.	4 Deklaratat Tatimore 23-24-25.pdf
5.	5 Raporti i auditimit per vitin 25-24-23-22.pdf
6.	6 Autorizimi Vjollca Januzi - Fadil Januzin.pdf
7.	7 Deklarate Garancioni.pdf
8.	8 Lista e stafit dhe kontratat.pdf
9.	9 Durim Basha Diploma , cv , referencat kontrata , vendimi per menaxher te projektit (1).pdf
10.	10 Kontrata Diploma Cv Licenca Referenca Ing i Elektroteknikes Malush Muslijapdf.pdf
11.	11 Kontrata Diploma Licenca CV Ing i Hidroteknikes Kaltrina Ahmetaj.pdf
12.	12 RUZHDI-FEKA-Expert per Siguri dhe Shendet ne pune dhe Kontrata.pdf
13.	13 Kontrata dhe Diploma Eduard Geci Instalues i Elektrikes.pdf
14.	14 Rizah Baliu Pllakashtrues.pdf
15.	15 Fadil Januzi Per SSHP - Moler suvatures.pdf
16.	16 Lista e kontratave te realizume.pdf
17.	17Kontratat e realizume nga IDEALI COMPANY SH.P.K.pdf
18.	18 KONTRATA - Ndertimi i garazhes per nevojat te AMF-se ne Zhazhe.pdf
19.	19Raporti i pranimi teknik AMF Zhazhe.pdf
20.	20 Nje pjese e kontratave refrenca dhe transaksione financiare.pdf
21.	21Pjesa tjeter e kontratave referenca transaksione financiare.pdf
22.	22 Transaksione financiare.pdf
23.	23 Autorizim Biznesi Gjeneral Vjollca Januzi to Nazmi Januzi.pdf
24.	24 Lulzim Mazreku Diploma cv licenca referenca kontrata.pdf
25.	25 Sigurimi i tenderit LLOT 1.pdf
26.	26 Sigurimi i tenderit LLOT 2.pdf
27.	27Lista e paisjeve dhe marrevshjet per shfrytezim te makinerise..pdf

Kjo është me rëndësi të veçantë, pasi vetë Dosja e Tenderit, në pikën **10.1 – Informatat sekrete afariste**, përcakton se nëse një operator ekonomik dëshiron që informatat lidhur me gjendjen ekonomike/financiare apo aftësitë teknike/profesionale të trajtohen si informata sekrete afariste, ai duhet të dorëzojë kërkesë me shkrim duke përdorur formën e përcaktuar në Aneksin nr. 3 të Dosjes së Tenderit.

Gjithashtu, **Aneksi nr. 3** kërkon që operatori ekonomik të identifikojë konkretisht informacionet që kërkon të mbahen sekrete dhe të japë arsyetimin përkatës se përse qasja

publike në ato informata do t'i shkaktonte dëm material interesave të tij legjitime komerciale.

Në rastin konkret, nga lista zyrtare e dokumenteve të ofertës nuk rezulton se OE IDEALI COMPANY SH.P.K. ka paraqitur një kërkesë të tillë, ndërsa pavarësisht kësaj AK ka refuzuar të na ofrojë qasje në Raportin e Auditimit dhe Deklaratat Tatimore Vjetore.

*Këto dokumente janë drejtpërdrejt të lidhura me përmbushjen e kriterit të kapacitetit ekonomik dhe financiar. Dosja e Tenderit ka kërkuar për **LOT 1 qarkullim financiar prej së paku 550,000.00 euro në tri vitet e fundit**, ndërsa si dëshmi ka kërkuar Deklaratat Tatimore Vjetore të shoqëruara me Raportin e Auditimit të pasqyrave financiare.*

Moslejimi i qasjes në këto dokumente na ka pamundësuar që të verifikojmë nëse OE IDEALI COMPANY SH.P.K. e ka përmbushur realisht kriterin ekonomik dhe financiar të përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Shkelja e Autoritetit Kontraktues

Konsiderojmë se AK ka vepruar në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në vetë Dosjen e Tenderit për trajtimin e informatave si sekret afarist, pasi ka kufizuar qasjen në dokumente për të cilat nga dokumentacioni i ofertës nuk rezulton se OE ka paraqitur kërkesën e detyrueshme sipas Aneksit nr. 3.

AK nuk mund ta trajtojë automatikisht një dokument si sekret afarist pa u respektuar procedura e përcaktuar për këtë qëllim, përkatësisht pa ekzistuar kërkesa me shkrim e OE-së dhe identifikimi i informatave që kërkohet të mbrohen.

Kërkesë ndaj Autoritetit Kontraktues

Duke u bazuar në faktet dhe provat e paraqitura më sipër, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që Pretendimin tonë nr. 5 ta aprovojë si të bazuar.

Pretendimi Nr. 6

AK ka bërë vlerësim jo të plotë të Kërkesës nr. 1 për kapacitetin teknik dhe profesional, pasi nuk ka evidentuar dhe verifikuar mospërputhjet ndërmjet Listës së Kontratave të Realizuara të OE IDEALI COMPANY SH.P.K. dhe dokumenteve dëshmuese të paraqitura për këto kontrata.

Autoriteti Kontraktues, në kuadër të Kërkesës nr. 1 – Kapaciteti teknik dhe profesional, ka kërkuar që Operatori Ekonomik të dëshmojë se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë minimale prej:

400,000.00 euro për LOT 1,

*Si Dëshmi nr. 1, AK ka kërkuar listën e kontratave të realizuara, të shoqëruar me referenca ose certifikata për kryerjen me sukses të punëve. Për kontratat e realizuara në sektorin privat, AK ka kërkuar shprehimisht **referencat e palëve të nënshkruara nga pranuesit e punës dhe transaksionet financiare.***

OE IDEALI COMPANY SH.P.K. ka paraqitur një listë të kontratave të realizuara, mirëpo

nga krahasimi i kësaj liste me kontratat, referencat dhe transaksionet financiare të dorëzuara rezultojnë **mospërputhje konkrete të cilat është dashur të verifikohen nga AK gjatë procesit të vlerësimit.**

Në disa prej kontratave të paraqitura me **ISA SH.P.K.**, datat e përfundimit të punëve të evidentuara në referenca nuk përputhen me të dhënat e deklaruara në listën e kontratave. Për shembull, nga referencat rezulton se një projekt ka përfunduar në **dhjetor 2022**, ndërsa një tjetër në **shkurt 2023**.

Këto data janë me rëndësi thelbësore, pasi Kërkesa nr. 1 kufizon kontratat e pranueshme në **periudhën trevjeçare nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë**. Për këtë arsye, AK ka qenë e obliguar të përcaktojë datën reale të përfundimit të secilës kontratë dhe të verifikojë nëse ajo hyn brenda periudhës së kërkuar.

Gjithashtu, për kontratën me **Infinity Development Group 5+ SH.P.K.**, nga dokumentacioni rezulton mospërputhje në vlerë: në dokumentin kontraktual figuron vlera rreth **20,888 euro**, ndërsa në referencën përkatëse figuron vlera **23,813.50 euro**.

Një mospërputhje e tillë kërkon verifikim të qartë nga AK se **cila është vlera reale e punëve të realizuara** që mund të merret parasysht në llogaritjen e pragut minimal të kërkuar.

Po ashtu, për disa kontrata private, dokumentacioni i transaksioneve financiare nuk përputhet plotësisht me vlerat e deklaruara në kontrata dhe referenca.

Për shembull, në rastin e **Fidan Camilit**, referenca deklaron vlerën e kontratës prej **46,474.42 euro**, ndërsa në dokumentacionin financiar janë paraqitur transaksione prej **23,237.21 euro** dhe **19,315.74 euro**, të cilat nuk e arrijnë vlerën e plotë të deklaruar në referencë.

Rrjedhimisht, **AK nuk ka mundur ta konsiderojë automatikisht si të dëshmuar shumën e deklaruar në Listën e Kontratave pa bërë krahasimin dhe verifikimin e dokumenteve mbështetëse të kërkuara nga vetë Dosja e Tenderit.**

Shkelja e Autoritetit Kontraktues

Konsiderojmë se në këtë pikë **AK ka vepruar në kundërshtim me Nenin 40.2 të Rregullores për Prokurimin Publik**, sipas të cilit tenderët duhet të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në **Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit**. AK nuk mund t'i ndryshojë, modifikojë apo anashkalojë kërkesat e përcaktuara paraprakisht.

Gjithashtu, sipas **Nenit 40.6 të Rregullores**, tenderi konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse operatori ekonomik **i përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.**

Neni 56.1.1 i LPP-së përcakton se vlerësimi duhet të bëhet sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit.

Ndërsa **Neni 59.4 i LPP-së** përcakton se një tender konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse është në përputhshmëri me **të gjitha kërkesat e parashtruara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit.**

Për më tepër, për kontratat e punëve, **Neni 69.6.2 i LPP-së** kërkon që projektet e punëve të

realizuara në periudhën trevjeçare të përcillen me certifikata për kryerje dhe/ose përfundim të kënaqshëm, të cilat përcaktojnë **vlerën, datën dhe vendndodhjen e punëve**, si dhe dëshmojnë se ato janë përfunduar siç duhet.

Prandaj, mosverifikimi i mospërputhjeve ndërmjet Listës së Kontratave, kontratave, referencave dhe transaksioneve financiare përbën vlerësim jo të plotë të Kërkesës nr. 1 dhe është në kundërshtim me Nenin 56 dhe Nenin 59 të LPP-së, si dhe me Nenin 40 të Rregullores për Prokurimin Publik.

Kërkesë ndaj Autoritetit Kontraktues

Duke u bazuar në faktet dhe provat e paraqitura më sipër, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që Pretendimin tonë nr. 6 ta aprovojë si të bazuar.

PRETENDIMET NDAJ ELIMINIMIT TË GOE HAJRUSH J. SHOSHI B.I.; NNP CTA SH.P.K.; INTERING CONSTRUCTION SH.P.K.

Pretendimi Nr. 7

Eliminimi i pabazuar lidhur me përvojën e Liderit dhe moskërkimi i sqarimit

Sipas Kërkesës 1 të Dosjes së Tenderit për **LLOT 1**, OE/GOE duhet të dëshmojë kontrata të përfunduara me sukses të natyrës së ngjashme në vlerë minimale prej **400,000.00 €**, ndërsa në rast të konzorciumit Lideri duhet të ketë së paku **60%**, përkatësisht **240,000.00 €**.

Në këtë procedurë kemi ofertuar si Grup i Operatorëve Ekonomikë, me **“Hajrush J. Shoshi” B.I. si Lider dhe CTA SH.P.K. si anëtare**. Përvoja e kontestuar lidhet me të njëjtin projekt: **“Ndërtimi i Sallës së Sporteve në Vrellë – Vazhdim”**.

CTA SH.P.K. ka paraqitur kontratën publike për këtë projekt në vlerë **333,333.33 €**, aneks-kontratën për punët shtesë në vlerë **33,015.27 €**, pra gjithsej **366,348.60 €**, si dhe **Raportin e Pranimit Teknik**, i cili konfirmon përfundimin dhe pranimin e punimeve më **09.10.2025**.

Lideri **“Hajrush J. Shoshi” B.I.** ka paraqitur kontratën e lidhur me **CTA SH.P.K.** për realizimin e punimeve në të njëjtin projekt. Sipas kontratës, **vlera përfundimtare përcaktohet sipas çmimeve njësi dhe situacioneve/fazave të realizuara**. Për këtë arsye, vlera reale e realizimit nuk mund të përcaktohet vetëm nga një shumë e shënuar në Aneksin 6, por duhet të verifikohet kundrejt faturave, situacioneve dhe dokumentacionit përcjellës.

Punimet e realizuara nga **“Hajrush J. Shoshi” B.I.** në kuadër të kësaj kontrate janë faturuar sipas situacioneve përkatëse, si vijon:

- Fatura 1 nr. 03/2024, sipas situacionit – **75,000.00 €**
- Fatura 2 nr. 04/2024, sipas situacionit – **25,000.00 €**
- Fatura 3 nr. 06/2024, sipas situacionit – **30,000.00 €**
- Fatura 4 nr. 01/2025, sipas situacionit – **30,000.00 €**
- Fatura 5 nr. 06/2025, sipas situacionit – **52,500.00 €**
- Fatura 6 nr. 10/2025, sipas situacionit – **12,000.00 €**
- Fatura 7 nr. 11/2025, sipas situacionit – **10,000.00 €**
- Fatura 8 nr. 13/2025, e faturuar më **01.12.2025**, sipas situacionit – **16,500.00 €**

Vlera totale e punimeve të faturuara sipas situacioneve është 251,000.00 €.

*Në Aneksin 6 është shënuar vlera **234,500.00 €**. Kjo shumë përputhet saktësisht me shtatë faturat/pagesat e para:*

$$75,000 + 25,000 + 30,000 + 30,000 + 52,500 + 12,000 + 10,000 = 234,500.00 \text{ €}$$

*Pra, diferenca nuk është e paidentifikueshme. Ajo është saktësisht **16,500.00 €** dhe lidhet me **Faturën nr. 13/2025, datë 01.12.2025, “Fatura 8 sipas situacionit”**.*

Dëshmia nr. 1 – Qarkullimi bankar NLB prej 234,500.00 €

*Qarkullimi bankar evidenton shtatë pagesa të CTA SH.P.K. ndaj “Hajrush J. Shoshi” B.I. në vlerë totale prej **234,500.00 €**.*

Kjo provë e shpjegon shumën e pasqyruar në Aneksin 6, por nuk dëshmon se kjo ishte vlera përfundimtare e punimeve të realizuara dhe të faturuara.

nga 10.10.2024 deri 31.12.2025

Qarkullimi në periudhën

Urdhërdhënësi / Përfituesi CTA

UNIKU

1706017400688344EUR

(Numri i llogarisë)

Shuma e miratuar e mbiterheqjes	Bilanci i mbiterheqjes	Bilanci i disponueshëm	AoH	Bilanci i hapjes	Qarkullimi ditor		Bilanci i mbylljes	Numri i urdhëresës	
					Debi	Kredi		Debi	Kredi
0,00 EUR	0,00 EUR	0,00 EUR	-0,30 EUR	0,00 EUR	0,00	234.500,00	1.064,93 EUR	0	7

Nr. Rend or i urdhërit	Data	Përfituesi	Përshkrimi i transaksionit	Lloji i pagesës	Numri i transaksionit	Debi	Kredi	Total
1	24.11.2025 10:22:04	NNP CTA SHPK	BPB-NNP CTA SHPK- PAGES EFATUES ME NR 11/2025 - KK051300001400033389 NN	Të hyra në Llogari	K2528014460001		10.000,00 EUR	10.157,01 EUR
2	02.09.2025 08:47:04	NNP CTA SHPK	BPB-NNP CTA SHPK- PAGES E FAT ME NR 10/2025 777- KK051300001400033389 NNP CTA SHPK	Të hyra në Llogari	K2527087587001		12.000,00 EUR	12.000,00 EUR
3	05.06.2025 11:37:03	NNP CTA SHPK	BPB-NNP CTA SHPK- PAGES E FAT ME NR 6 025- KK051300001400033389 NNP CTA SHPK	Të hyra në Llogari	K2526087269001		52.500,00 EUR	52.500,00 EUR
4	03.02.2025 08:47:03	NNP CTA SHPK	BPB-NNP CTA SHPK- PAGES E FAT ME NR 01/2025 777- KK051300001400033389 NNP CTA SHPK	Të hyra në Llogari	K2524719733001		30.000,00 EUR	30.000,00 EUR
5	23.12.2024 08:47:02	NNP CTA SHPK	BPB-NNP CTA SHPK- PAGES E FAT ME NR 06/2024 777- KK051300001400033389 NNP CTA SHPK	Të hyra në Llogari	K2424142527001		30.000,00 EUR	30.000,00 EUR
6	06.12.2024 08:42:05	NNP CTA SHPK	BPB-NNP CTA SHPK- PAGES E FAT ME NR 04/2024 777- KK051300001400033389 NNP CTA SHPK	Të hyra në Llogari	K2423957393001		25.000,00 EUR	25.000,00 EUR

Faqja 1 / 2 19.03.2026 09:53


Nr. Rend or i urdhërit	Data	Përfituesi	Përshkrimi i transaksionit	Lloji i pagesës	Numri i transaksionit	Debi	Kredi	Total
7	18.11.2024 11:32:05	NNP CTA SHPK	BPB-NNP CTA SHPK- PAGES E FAT ME NR 03/2024 147- KK051300001400033389 NNP CTA SHPK	Të hyra në Llogari	K2423779959001		75.000,00 EUR	75.000,00 EUR
						0,00	234.500,00	

NLB Banka është anëtar i Fondit për Sigurimin e Depozitave të Kosovës (FSDK). FSDK do të kompensojë depozituesit e siguruar nëse banka nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e saj financiare, deri në € 5,000. Depozituesit e siguruar janë persona fizik dhe persona juridikë, që përndryshe nuk janë të përjashtuar nga skema. Për informacione të tjera në lidhje me skemën e sigurimit të depozitave, ju lutem pyesni në degën tuaj lokale në bankën tuaj ose drejtohuni në faqen e internetit të FSDK-së: fsdk.org .

Limiti i sigurimit do të jetë si vijon: 5,000 € (nga 01.01.2018).

NLB Banka is member of the Deposit Insurance Fund of Kosovo (DIFK). DIFK shall reimburse insured depositors if a bank is unable to meet its financial obligations up to € 5,000. Insured depositors are individuals and legal entities that are otherwise not excluded from the scheme. For further information about the deposit insurance scheme, please ask at your local branch in your bank or refer to DIFK's website: fsdk.org .

The coverage limit will increase as follows: €5,000 (from 01.01.2018)



Dëshmia nr. 2 – Fatura nr. 13/2025, datë 01.12.2025

Më 01.12.2025, “Hajrush J. Shoshi” B.I. ka lëshuar **Faturën nr. 13/2025**, me përshkrimin **“Fatura 8 sipas situacionit”**, në vlerë totale prej **16,500.00 €**.

Kjo faturë e shpjegon saktësisht diferencën ndërmjet shumës prej 234,500.00 € në Aneksin 6 dhe vlerës së plotë të realizimit prej 251,000.00 €.

Shitesi

Hajrush J Shoshi B.I**Kashicë- Istog**

Bleri

NNP CTA SH.P.K

811322776

Prishtinë

Data 01.12.2025

Faturë Nr: 13/2025

Nr	Përshkrimi	Nj. mat	Sasia	Çmimi pa TVSH	Shuma me TVSH
1	Fatura 8 simbasi situacionit	cop	1	13,983.05	16,500.00
2					-
3					-
4					-
5					-
6					-
7					-
8					-
9					-
10					-
TOTALI					16,500.00

Pagesa të bëhet në xhirollogarin bankare Nr. 1706017400688344 NLB Banka

Totali pa TVSh

13,983.05

TVSH-ja

2,516.95

Totali me TVSh

16,500.00



Pranoj:

Pagesa të bëhet në afatin prej 30 ditë nga dita e pranimit të Fatures

Rrjedhimisht:

$$234,500.00 \text{ €} + 16,500.00 \text{ €} = 251,000.00 \text{ €}$$

Pra, Lideri e tejkalon minimumin prej 240,000.00 € me 11,000.00 €.

Fatura nr. 13/2025 konfirmohet nga regjistrimet reciproke të të dy palëve

Rëndësia provuese e Faturës nr. 13/2025 forcohet edhe më tej nga fakti se transaksioni nuk figuron vetëm në dokumentacionin e Liderit.

I njëjti transaksion është evidentuar reciprokisht:

- si **shitje** në Librin e Shitjeve të "Hajrush J. Shoshi" B.I.; dhe

- si **blerje** në Librin e Blerjeve të NNP CTA SH.P.K.

Të dhënat përputhen si vijon:

Elementi	Libri i Shitjeve	Libri i Blerjeve
Nr. i faturës	13/2025	13/2025
Data	01.12.2025	01.12.2025
Shitësi	Hajrush J. Shoshi B.I.	Hajrush J. Shoshi B.I.
Blerësi	NNP CTA SH.P.K.	NNP CTA SH.P.K.
Baza	13,983.05 €	13,983.05 €
TVSH	2,516.95 €	2,516.95 €
Vlera totale	16,500.00 €	16,500.00 €

Dëshmia nr. 3 – Libri i Shitjeve i “Hajrush J. Shoshi” B.I.

Në Librin e Shitjeve figuron më 01.12.2025 Fatura nr. 13/2025 ndaj NNP CTA SH.P.K., me bazë të tatueshme 13,983.05 € dhe TVSH 2,516.95 €.

Nr.	Data	Emri i faturës	Emri i blerësit	Numri i fakturës	Numri i TVSH-së	Shitjet e lirpura nga TVSH					Shitjet e tatueshme me normën 18%										Shitjet e tatueshme me normën 8%					Totali i TVSH-së së shërbimeve me 8%
						Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	
1	01.12.2025	13/2025	NNP CTA SH.P.K.	010322776	1	4,588.66	4,588.66	13,983.05	2,516.95	2,516.95	2,516.95	2,516.95	2,516.95	2,516.95	2,516.95	2,516.95	2,516.95	2,516.95	2,516.95	2,516.95	2,516.95	2,516.95	2,516.95	2,516.95	2,516.95	2,516.95

Dëshmia nr. 4 – Libri i Blerjeve i NNP CTA SH.P.K.

Në Librin e Blerjeve të NNP CTA SH.P.K. figuron, po më 01.12.2025, e njëjta Faturë nr. 13/2025, me “Hajrush J. Shoshi” B.I. si shitës, bazë 13,983.05 € dhe TVSH 2,516.95 €.

Nr.	Data	Emri i faturës	Emri i shitësit	Numri i fakturës	Numri i TVSH-së	Shitjet e lirpura nga TVSH					Shitjet e tatueshme me normën 18%										Shitjet e tatueshme me normën 8%					Totali i TVSH-së së shërbimeve me 8%
						Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	Shitjet e lirpura nga TVSH	
1	01.12.2025	13/2025	Hajrush J. Shoshi B.I.	010322776	1	4,588.66	4,588.66	13,983.05	2,516.95	2,516.95	2,516.95	2,516.95	2,516.95	2,516.95	2,516.95	2,516.95	2,516.95	2,516.95	2,516.95	2,516.95	2,516.95	2,516.95	2,516.95	2,516.95	2,516.95	2,516.95

Përputhja e numrit të faturës, datës, palëve, bazës tatimore dhe TVSH-së në dy regjistrat reciprokë përbën një gjurmë dokumentare të qartë dhe objektivist të verifikueshme të të njëjtit transaksion.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme, sepse nuk kemi vetëm një deklaram unilateral të Liderit. Shitësi e ka evidentuar transaksionin si shitje, ndërsa blerësi të njëjtin transaksion si blerje.

Prandaj, Fatura nr. 13/2025 dhe vlera prej 16,500.00 € nuk mund të trajtohen si një përvojë apo dokument i krijuar pas afatit, por si pjesë e realizimit të së njëjtës marrëdhënie kontraktore.

Pagesa e vitit 2026 është vetëm provë korroboruese

Fatura nr. 13/2025 është paguar më 25.08.2026, në vlerë prej 16,500.00 €, ndërsa

transaksioni bankar e identifikon pagesën me përshkrimin “pagesë e faturës 13-2025”.

Dëshmia nr. 5 – Pagesa bankare e Faturës nr. 13/2025



Banka për Biznes
RR. UKSHIN HOTI, NR. 128,
10000, Prishtinë
+383 38 620620
+383 38 620620
informata@bpbbank.com
www.bpbbank.com

Detajet e transaksionit

Statusi: Aprovuar

Data e transaksionit	25.08.2026 17:18:45
Numri i transaksionit	77702232383005
Urdhërdhënësi	NNP CTA SHPK
Llogaria e urdhërdhënësit	1300001400033389EUR
Adresa e urdhërdhënësit	MEHMET GRADICA HY 2 NR 6 PRISHTINE
Emri i përfituesit	HAJRUSH SHOSHI BI
Llogaria e përfituesit	1706017400688344
Adresa e përfituesit	N/A
Detajet e transaksionit	pagese e fatures 13-2025 1706017400688344 HAJRUSH SHOSHI BINLB - Banka
Info	
Shifra e pagesës	Pagesat Ndërbankare - E rregullt
Vlera	16.500,00 EUR

25.08.2026 05:19:10 PM



Kjo pagesë nuk përdoret si bazë për krijimin e përvojës në vitin 2026.

Ajo përdoret vetëm si provë shtesë që konfirmon shlyerjen e një detyrimi të identifikuar më herët me Faturën nr. 13/2025, datë 01.12.2025.

Pra, zinxhiri dokumentar është i qartë:

realizimi i punimeve → situacioni nr. 8 → Fatura nr. 13/2025 më 01.12.2025 → regjistrimi në Librin e Shitjeve → regjistrimi reciprok në Librin e Blerjeve → pagesa e mëvonshme e faturës.

Ky zinxhir provues e dallon qartë **momentin e realizimit dhe faturimit nga momenti i mëvonshëm i pagesës.**

AK është dashur ta sqarojë mospërputhjen para eliminimit

Në këto rrethana, shuma prej **234,500.00 €** në Aneksin 6 nuk është dashur të trajtohet automatikisht si provë se Lideri nuk e përmbush kriterin.

Ekzistonte një mospërputhje konkrete dhe e sqarueshme:

Aneksi 6: 234,500.00 €

Dokumentacioni i realizimit: 251,000.00 €

Diferenca prej **16,500.00 €** nuk lidhet me kontratë tjetër, projekt tjetër apo përvojë të krijuar pas afatit. Ajo identifikohet me **një faturë konkrete të datës 01.12.2025**, me situacionin nr. 8 dhe me regjistrimet reciproke të së njëjtës faturë te shitësi dhe blerësi.

Prandaj, kjo mospërputhje duhej të trajtohej së paku si **çështje që kërkonte sqarim dhe verifikim**, dhe jo automatikisht si mungesë e kapacitetit teknik.

Sipas **nenit 59.4 dhe nenit 72 të LPP-së**, si dhe **nenit 38 të Rregullores për Prokurimin Publik**, sqarimi është i mundshëm kur nuk ndryshohet materialisht oferta dhe kur dokumentacioni lidhet me një gjendje që ka ekzistuar para afatit dhe mund të verifikohet objektivisht.

Në rastin konkret, sqarimi:

- nuk ndryshon Liderin;
- nuk ndryshon GOE-në;
- nuk shton kontratë të re;
- nuk shton projekt të ri;
- nuk shton punime të reja;
- nuk krijon përvojë pas afatit.

Ai vetëm verifikon **vlerën reale të realizimit të kontratës dhe projektit tashmë të deklaruar në ofertë.**

Nëse AK ka dyshim lidhur me autenticitetin ose evidentimin tatimor të Faturës nr. 13/2025, **kërkojmë që, nëse e konsideron të arsyeshme dhe brenda kompetencave ligjore, të bëjë ose të kërkojë verifikimin përkatës edhe pranë Administratës Tatimore të Kosovës (ATK)**, lidhur me evidentimin e të njëjtës faturë në Librin e Shitjeve të “Hajrush J. Shoshi” B.I. dhe Librin e Blerjeve të NNP CTA SH.P.K.

Një verifikim i tillë do ta zgjidhte objektivisht çdo dyshim lidhur me këtë transaksion.

KËRKESA DREJTUAR AUTORITETIT KONTRAKTUES

Për arsyet dhe provat e paraqitura më sipër, **kërkojmë që Autoriteti Kontraktues ta aprovojë Pretendimin nr. 7 si të bazuar.**

Pretendimi Nr. 8

Vlerësim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes ekonomike dhe financiare të Grupit të Operatorëve Ekonomikë, në kundërshtim me nenet 68, 71 dhe 72 të LPP-së dhe nenin 38 të Rregullores për Prokurimin Publik

Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësim të gabuar dhe jo të plotë të dokumentacionit të dorëzuar nga Grupi i Operatorëve Ekonomikë lidhur me kërkesën për gjendjen ekonomike dhe financiare.

Sipas Dosjes së Tenderit, për **LLOT 1** është kërkuar që Operatori Ekonomik të ketë qarkullim financiar me vlerë të përgjithshme prej së paku **550,000.00 €**, gjatë periudhës përkatëse trevjeçare para publikimit të Njoftimit për Kontratë, ndërsa si dëshmi janë kërkuar Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës, të shoqëruara me dokumentacionin financiar/auditues të kërkuar.

Kriteri financiar duhet të vlerësohet ndaj Grupit të OE-ve si tërësi

Oferta është dorëzuar nga **Grupi i Operatorëve Ekonomikë Hajrush J. Shoshi B.I. – Lider; NNP CTA SH.P.K. – anëtar; INTERING CONSTRUCTION SH.P.K. – anëtar.**

Dokumentacioni i grupit konfirmon se lideri ka pjesëmarrje 60%, NNP CTA SH.P.K. 30% dhe INTERING CONSTRUCTION SH.P.K. 10%.

Kjo rrethanë ka rëndësi të drejtpërdrejtë juridike. Neni 71 paragrafi 4 i LPP-së përcakton shprehimisht se kërkesat e vendosura sipas nenit 68 për gjendjen ekonomike dhe financiare **aplikohen ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individualë të grupit.**

Edhe Rregullorja për Prokurimin Publik e përcakton të njëjtin parim, duke theksuar se kërkesa sipas nenit 68 zbatohet ndaj grupit si tërësi.

Rrjedhimisht, përderisa në Dosjen e Tenderit nuk është përcaktuar shprehimisht që kriteri financiar prej 550,000.00 € duhet të përmbushet individualisht nga një anëtar i caktuar apo nga lideri në një përqindje të caktuar, AK ka qenë i obliguar që kapacitetin ekonomik dhe financiar ta vlerësojë duke marrë në konsideratë **kapacitetet dhe dokumentacionin financiar të të gjithë Grupit të OE-ve.**

Në ofertë është dorëzuar dokumentacion financiar për periudhën relevante dhe konstatimi se “mungon viti 2023” nuk qëndron

Në kundërshtim me konstatimin e AK-së se mungon dokumentacioni financiar për vitin 2023, në ofertën e dorëzuar gjendet Deklarata Tatimore Vjetore e **INTERING CONSTRUCTION SH.P.K. për vitin 2023**, së bashku me deklaratën e të hyrave dhe shpenzimeve, ku figurojnë të ardhura bruto në shumën **872,921.40 €**.

Po ashtu, për vitin 2024 janë paraqitur të ardhura bruto prej **903,580.90 €**, ndërsa për vitin 2025 prej **629,637.42 €**.

Vetëm nga këto deklarata tatimore rezulton qarkullim trevjeçar prej:

$$872,921.40 € + 903,580.90 € + 629,637.42 € = 2,406,139.72 €$$

Pra, vetëm nga dokumentacioni tatimor i një anëtari të Grupit rezulton qarkullim financiar

shumëfish më i lartë se minimumi prej **550,000.00 €** i kërkuar për LLOT 1.

Për më tepër, të hyrat e vitit 2023 konfirmohen edhe në pasqyrat financiare të INTERING CONSTRUCTION SH.P.K., ku paraqitet shuma prej rreth **872,921 €**.

Prandaj, konstatimi i AK-së se **“mungon viti 2023”** nuk pasqyron në mënyrë të plotë përmbajtjen faktike të ofertës.

Deklaratat Tatimore Vjetore janë vetë një nga dëshmitë e njohura nga neni 68 i LPP-së

Neni 68 i LPP-së përcakton se kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare mund t'u referohen maksimum tri viteve të fundit financiare dhe se operatorët ekonomikë mund ta dëshmojnë kapacitetin e tyre përmes referencave të përcaktuara në këtë nen.

Në mesin e këtyre referencave, neni 68.1.5 njih shprehimisht **Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës**.

Kështu, dokumentacioni tatimor i dorëzuar nga anëtarët e Grupit nuk është dokumentacion i parëndësishëm apo i palidhur me kriterin, por përbën vetë një nga format e dëshmisë që ligji e njih për verifikimin e gjendjes ekonomike dhe financiare.

NNP CTA SH.P.K. posedonte raporte të auditimit për vitet 2022, 2023 dhe 2024 para afatit të tenderimit

Një rrethanë tjetër me rëndësi vendimtare, e cila duhet të merret në konsideratë gjatë rivlerësimit, është fakti se anëtari i Grupit **NNP CTA SH.P.K. posedonte raporte të auditimit të pasqyrave financiare për vitet 2022, 2023 dhe 2024**.

Dokumentacioni i paraqitur përmban raport të veçantë të auditimit për pasqyrat financiare të vitit **2023**, të lëshuar gjithashtu i nënshkruar dhe vulosur nga auditori.

ku paraqitet opinioni i auditorit dhe dokumenti është i nënshkruar dhe vulosur nga auditori i licencuar.

Po ashtu, ekziston raport i veçantë i auditimit për pasqyrat financiare të vitit **2024**, gjithashtu i nënshkruar dhe vulosur nga auditori.

Ekzistenca e këtyre raporteve **para afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve** provohet edhe përmes komunikimit elektronik të datës **18.12.2025**, ku NNP CTA SH.P.K. ka pranuar tre dokumente të bashkëngjitura, konkretisht **2022.pdf, 2023.pdf dhe 2024.pdf**, me subjekt **“NNP CTA SHPK – RAPORTET E AUDITORIT 2022-2024”**.



Nnp Cta <nnpcta@gmail.com>

NNP CTA SHPK - RAPORTET E AUDITORIT 2022-2024**AFT & Consulting** <aft.shpk@gmail.com>
To: nnpcta@gmail.com

Thu, Dec 18, 2025 at 1:04 PM

AFT & Consulting
Accounting and Business Solutions
Cel: + 383 44 297 551
Email: aft.shpk@gmail.com
Str/Muhamrem Fejza 10000, Prishtinë, R. Kosoves

3 attachments

2024.pdf
5651K

2022.pdf
5688K

2023.pdf
5699K

<https://mail.google.com/mail/u/0/?ik=74830321b1&view=pt&search=all&permmsgid=msg-f:1851847579655309731&siml=msg-f:1851847579655309731>

1/1

Prandaj, nuk bëhet fjalë për dokumente të krijuara pas afatit të tenderimit, por për dokumente që kanë ekzistuar objektivisht shumë muaj para dorëzimit të ofertës.

Vetëm qarkullimi i audituar i NNP CTA SH.P.K. për vitet 2023 dhe 2024 e tejkalon kriterin prej 550,000.00 €

Rëndësia e këtyre raporteve nuk është vetëm formale.

*Nga pasqyrat financiare të audituara të NNP CTA SH.P.K. rezulton se për vitin 2023 të hyrat kanë qenë **648,970.00 €**.*

*Për vitin 2024, të hyrat e NNP CTA SH.P.K. kanë qenë **339,640.00 €**.*

Rrjedhimisht:

Viti 2023: 648,970.00 €

Viti 2024: 339,640.00 €

Gjithsej: 988,610.00 €

*Kërkesa minimale për LLOT 1 ka qenë **550,000.00 €**.*

Pra:

988,610.00 € – 550,000.00 € = 438,610.00 €

Kjo do të thotë se vetëm qarkullimi i audituar i NNP CTA SH.P.K. për vitet 2023 dhe 2024 e tejkalon kërkesën minimale të AK-së për LLOT 1 për 438,610.00 €.

Ky fakt është me rëndësi të veçantë, sepse kërkesa e Dosjes së Tenderit flet për një vlerë të përgjithshme prej së paku 550,000.00 € gjatë periudhës trevjeçare, dhe jo për detyrimin që

operatori të ketë nga 550,000.00 € në secilin vit veçmas.

Prandaj, vetëm dy nga vitet që bien brenda periudhës relevante, 2023 dhe 2024, mjaftojnë numerikisht për të dëshmuar se NNP CTA SH.P.K. e tejkalonte ndjeshëm pragun minimal financiar.

Raporti i auditimit për vitin 2022 ekziston gjithashtu, por nuk është e nevojshme që vlera e tij të përdoret në këtë kalkulim, pasi vetëm vitet 2023 dhe 2024 japin qarkullim prej **988,610.00 €**.

Kapaciteti financiar i Grupit ekzistonte; çështja eventuale ishte vetëm dokumentare

Këtu duhet bërë dallim i qartë ndërmjet:

kapacitetit financiar që ekzistonte në momentin e tenderimit, dhe dokumentit me të cilin ky kapacitet dëshmohej para AK-së.

Nga dokumentet e mësipërme rezulton se kapaciteti financiar nuk është krijuar pas afatit të tenderimit.

NNP CTA SH.P.K. i kishte realizuar të hyrat e viteve 2023 dhe 2024 dhe raportet e auditimit për këto vite ekzistojnë që në dhjetor 2025. Po ashtu, Deklaratat Tatimore Vjetore të anëtarëve të Grupit ishin pjesë e dokumentacionit të tenderit.

Prandaj, edhe nëse AK ka konsideruar se raportet përkatëse të auditimit nuk ishin bashkëngjitur në mënyrën e kërkuar në ofertë, kjo përbënte **mungesë eventuale të dokumentit dëshmuar**, dhe jo mungesë të kapacitetit ekonomik dhe financiar.

Neni 68.3 lejon dëshmimin e gjendjes financiare edhe përmes dokumentit tjetër të përshtatshëm

Neni 68.3 i LPP-së përcakton se, kur për ndonjë arsye të vlefshme operatori ekonomik nuk është në gjendje të sigurojë referencën e kërkuar nga AK, atij i lejohet të demonstrojë gjendjen ekonomike dhe financiare përmes një dokumenti tjetër që AK, në ushtrimin e diskrecionit të arsyeshëm, e konsideron të përshtatshëm.

Kjo dispozitë tregon se qëllimi i nenit 68 është **verifikimi real i gjendjes ekonomike dhe financiare**, dhe jo trajtimi i një mangësie eventuale dokumentare si provë automatike se operatori nuk ka kapacitet financiar.

Në rastin konkret, kapaciteti ishte i verifikueshëm përmes Deklaratave Tatimore Vjetore, pasqyrave financiare dhe raporteve të auditimit që ekzistojnë para afatit të tenderimit.

AK kishte bazë ligjore të kërkonte sqarimin dhe kompletimin e raporteve të auditimit

Neni 72.1 i LPP-së përcakton se kur informacioni apo dokumentacioni është ose duket të jetë jo i plotë apo i gabuar, ose kur mungojnë dokumente specifike, AK mund të kërkojë nga operatori ekonomik që ta dorëzojë, plotësojë, sqarojë apo kompletojë dokumentacionin.

Edhe më e rëndësishme është pika 72.3, sipas së cilës sigurimi i informacionit që mungon aplikohet për dokumentet **ekzistenca e të cilave është e fiksuar para skadimit të afatit për**

dorëzimin e tenderëve dhe mund të verifikohet objektivisht.

Në rastin e NNP CTA SH.P.K. ky kusht plotësohet qartazi.

Raportet e auditimit për vitet 2022, 2023 dhe 2024 ekzistojnë dhe ishin në posedim të kompanisë që më **18.12.2025**, ndërsa procedura konkrete e tenderimit është zhvilluar më vonë.

Prandaj, kërkitimi i këtyre raporteve gjatë sqarimit **nuk do ta ndryshonte ofertën, nuk do të krijonte qarkullim të ri dhe nuk do të krijonte një kapacitet financiar pas afatit.** Do të paraqitej vetëm dokumenti që provonte një gjendje financiare që kishte ekzistuar paraprakisht.

Neni 38.3 i Rregullores e përforcon drejtpërdrejt këtë mundësi

Neni 38.3 i Rregullores për Prokurimin Publik, i ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, përcakton shprehimisht se AK-së i lejohet gjatë vlerësimit të kërkojë dhe të marrë edhe informacione apo dokumente që mungojnë në tender, kur këto dokumente paraqesin objektivisht prova të mjaftueshme që pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve. Neni 38.6 përcakton afat prej jo më pak se pesë ditësh për sqarimin e tenderit.

Raportet e auditimit të NNP CTA SH.P.K. plotësojnë pikërisht këtë karakteristikë: **ato ekzistojnë para tenderimit dhe dëshmonin të hyrat e realizuara shumë kohë para dorëzimit të ofertës.**

Vetë Udhëzuesi i KRPP-së e identifikon mungesën e dëshmisë financiare si rast të sqarueshëm

Udhëzuesi Nr. 001/2023 i KRPP-së, në kapitullin për sqarimin e tenderëve gjatë procesit të vlerësimit, jep shembull konkret:

“Mungon dëshmia mbi gjendjen ekonomike dhe financiare” → “Mund të kërkojen informata sqaruese”, me referencë pikërisht në nenin 68 të LPP-së.

Situata konkrete është madje më e favorshme për sqarim, sepse në tender nuk mungonte çdo informacion financiar. Deklaratat Tatimore Vjetore ishin paraqitur, ndërsa dokumentet plotësuese të auditimit të NNP CTA SH.P.K. ekzistojnë objektivisht para afatit.

Prandaj, nëse AK kishte dyshim mbi plotësinë e dokumentacionit financiar të Grupit, kishte në dispozicion mekanizmin ligjor për ta sqaruar atë para se ta trajtonte mungesën eventuale të dokumentit si arsye eliminimi.

Eliminimi për një mangësi eventuale dokumentare nuk mund të barazohet me mungesën e kapacitetit financiar

Në rastin konkret AK ka bërë një barazim të gabuar ndërmjet dy çështjeve juridikisht të ndryshme: **posedimit të kapacitetit financiar dhe plotësisë formale të dokumentacionit që provon atë kapacitet.**

Nga dokumentacioni rezulton se INTERING CONSTRUCTION SH.P.K. kishte deklaruar qarkullim trevjeçar prej **2,406,139.72 €**, ndërsa vetëm NNP CTA SH.P.K. kishte qarkullim të

audituar prej **988,610.00 € për vitet 2023 dhe 2024.**

Pra, nuk kemi të bëjmë me një Grup që nuk e arrinte pragun prej 550,000.00 €. Përkundrazi, kemi të bëjmë me një Grup, kapaciteti financiar i të cilit e tejkalonte dukshëm kriterin minimal, ndërsa AK e ka eliminuar për çështje që lidhen me mënyrën e dokumentimit të këtij kapaciteti.

*Nga të gjitha faktet dhe dispozitat e mësipërme rezulton se Autoriteti Kontraktues nuk e ka vlerësuar kriterin financiar në raport me **Grupin e OE-ve si tërësi**, ka konstatuar gabimisht mungesën e dokumentacionit për vitin 2023, nuk i ka vlerësuar në mënyrë të plotë Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara, si dhe nuk ka marrë parasysh faktin se anëtari **NNP CTA SH.P.K. posedonte raporte të auditimit të krijuara para afatit të tenderimit**, të cilat vetëm për vitet 2023 dhe 2024 dokumentojnë qarkullim prej **988,610.00 €**, ose **438,610.00 € mbi minimumin e kërkuar për LLOT 1.***

Nëse AK ka konsideruar se këto raporte apo dëshmi të tjera financiare mungonin në ofertë, ekzistenca e tyre para afatit të tenderimit i bënte ato dokumente objektivisht të verifikueshme dhe të përshtatshme për t'u kërkuar në kuadër të mekanizmit të sqarimit sipas nenit 72 të LPP-së dhe nenit 38.3 të Rregullores. Kërkimi i tyre nuk do të ndryshonte materialisht tenderin dhe as nuk do të krijonte një kapacitet të ri pas afatit, por vetëm do të dokumentonte një gjendje ekonomike dhe financiare ekzistuese.

KËRKESA DREJTUAR AUTORITETIT KONTRAKTUES

Për këto arsye, kërkojmë që Pretendimi nr. 2 të aprovohet si i bazuar,

PRETENDIMET NDAJ ELIMINIMIT TË OE TË SHPALLUR FITUS AGE group SH.P.K.,

Pretendimi Nr. 9

– Kontrata e dorëzuar nuk dëshmon angazhimin e ekspertit në pozitën e kërkuar nga AK

Autoriteti Kontraktues, përmes **Kërkesës 6**, ka kërkuar shprehimisht:

“Një Ekspert për Siguri dhe Shëndet në Punë të certifikuar nga MPMS (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale)...”

Ndërsa, si **Dëshmi 6**, AK ka kërkuar ndër të tjera:

“Kontrata e punës kopje nga origjinali e nënshkruar nga të dy palët dhe e vulosur nga OE valide ose parakontrata në emër të projektit.”

*Pra, kontrata/parakontrata e kërkuar nga AK duhet të dëshmojë angazhimin e personit që propozohet për plotësimin e **Kërkesës 6**, përkatësisht angazhimin e tij si **Ekspert për Siguri dhe Shëndet në Punë të certifikuar nga MPMS.***

*Mirëpo, nga dokumentacioni i dorëzuar nga OE rezulton se kontrata e punës e z. **Muhamet Hamiti** nuk është lidhur për këtë pozitë. Në kontratën e dorëzuar, në rubrikën “Profesioni”,*

z. Muhamet Hamiti është përcaktuar shprehimisht si:

“Ekspert i certifikuar nga AME për mbrojtje nga zjarri.”

Në bazë të nenit 10 dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës të Republikën e Kosovës, dhe akteve të brendshme të kompanisë (rregullore, statute) palët e kësaj kontrate në bazë të autorizimeve të tyre si subjekte të së drejtës dhe marrëdhënies së punës, lidhin:

KONTRATË PUNE PËR KOHË TË KAKTUAR

Për projektin Rregullimi i Qendrës së Kulturës Aneksi A&B (LLOT 1);
Rregullimi i nyjeve sanitare në Qendrën e Kulturës, Palestrën Sportive dhe në
Muzeun e Qytetit (LLOT 2) 642-26-4255-5-2-1

Punëdhënësi	
Emri i Kompanisë: AGE GROUP sh.p.k	Nr. i regjistrimit të biznesit: 810733865
Adresa: Rahovec Rruga UÇK-së p.n	
Përfaqësuesi: Tahir Bala	

I/E Punësuari/a	
Emri dhe mbiemri: Muhamet Hamiti	Nr. personal i identifikimit: 1019691752
Vendbanimi: Dumnice e Poshtme	Profesioni: Ekspert i certifikuar nga AME për mbrojtje nga zjarri
Nr. i xhirlogarisë bankare:	

Vlefshmëria e kontratës		
Për një periudhë të caktuar deri në përfundim të projektit Rregullimi i Qendrës së Kulturës Aneksi A&B (LLOT 1); Rregullimi i nyjeve sanitare në Qendrën e Kulturës, Palestrën Sportive dhe në Muzeun e Qytetit (LLOT 2) 642-26-4255-5-2-1	Data e fillimit të punës: 24.06.2026	Puna provuese:

Orari dhe vendi i punës		
Numri i orëve të punës në javë: 40 orë	Orari i punës: 08.00-16.00	Orët shtesë:
Pushimi gjatë orarit të punës:		Vendi i punës: Rahovec

Kompensimi i pagës
Paga neto: 391.45 Euro muaj; 80orë

Ky profil nuk është profili që ka kërkuar Autoriteti Kontraktues në Kërkesën 6. **Eksperti i certifikuar nga AME për mbrojtje nga zjarri dhe Eksperti për Siguri dhe Shëndet në Punë i certifikuar nga MPMS** paraqesin dy kualifikime dhe dy fusha të ndryshme profesionale.

Edhe pse kontrata është për projektin konkret dhe përfshin të dy LLOT-et, kjo nuk e ndryshon faktin se **pozita/profesioni për të cilin është angazhuar z. Muhamet Hamiti në vetë kontratën nuk është pozita e kërkuar në Kërkesën 6.**

Fakti se z. Muhamet Hamiti posedon një certifikatë të MPMS-së për Siguri dhe Shëndet në Punë nuk e ndryshon përmbajtjen e kontratës së dorëzuar. **Certifikata dëshmon kualifikimin e personit, ndërsa kontrata e punës, e kërkuar veçmas nga AK, duhet të dëshmojë angazhimin e tij për projektin në pozitën për të cilën është propozuar.**

Në rastin konkret, dokumenti i dorëzuar si kontratë pune dëshmon angazhimin e z. Muhamet Hamiti si **Ekspert i certifikuar nga AME për mbrojtje nga zjarri**, dhe jo si **Ekspert për Siguri dhe Shëndet në Punë të certifikuar nga MPMS**.

Rrjedhimisht, ekziston një mospërputhje substanciale ndërmjet asaj që **AK ka kërkuar** dhe asaj që **OE ka dëshmuar me kontratën e dorëzuar**.

Përfundimisht, konsiderojmë se OE nuk e ka plotësuar Dëshminë 6 në pjesën e kontratës së punës, pasi nuk ka paraqitur kontratë pune ose parakontratë që dëshmon angazhimin e z. Muhamet Hamiti si **Ekspert për Siguri dhe Shëndet në Punë të certifikuar nga MPMS**, por ka paraqitur kontratë për një profil tjetër profesional, konkretisht **Ekspert i certifikuar nga AME për mbrojtje nga zjarri**.

OE fitues nuk e ka përmbushur **Dëshminë 6 sipas kërkesës së përcaktuar në Dosjen e Tenderit**, për faktin se kontrata e dorëzuar nuk dëshmon angazhimin e z. Muhamet Hamiti në pozitën **Ekspert për Siguri dhe Shëndet në Punë të certifikuar nga MPMS**, por në një profil tjetër profesional, përkatësisht **Ekspert i certifikuar nga AME për mbrojtje nga zjarri**.

Mosplotësimi i Dëshmisë 6 bie ndesh me nenin 59.4 të LPP-së, sipas të cilit tenderi konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse është në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, si dhe me nenin 69 të LPP-së lidhur me dëshmimin e aftësisë teknike dhe profesionale. Po ashtu, sipas nenit 40.6 të Rregullores Nr.001/2022, tenderi konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse OE përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Në rastin konkret, kontrata e dorëzuar nuk dëshmon angazhimin e ekspertit në pozitën e kërkuar nga AK, prandaj kjo kërkesë nuk është përmbushur.

Kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që këtë pretendim ta pranojë si të bazuar

Pretendimi Nr. 10

Pretendimi – Nuk është dëshmuar minimumi prej 5 viteve përvojë profesionale pas certifikimit në fushën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë

Autoriteti Kontraktues, në **Kërkesën 6**, ka kërkuar:

“Një Ekspert për Siguri dhe Shëndet në Punë të certifikuar nga MPMS (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale) me përvojë pune minimum 5 vite pas certifikimit.”

Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se z. **Muhamet Hamiti** është certifikuar nga MPMS më 17.05.2017 si **“Person fizik i certifikuar për aktivitete nga lëmi i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë”**.

Megjithatë, fakti se nga data e certifikimit deri në datën e dorëzimit të tenderit kanë kaluar

më shumë se pesë vite **nuk është në vetvete dëshmi se personi ka ushtruar pesë vite përvojë pune profesionale pas certifikimit në fushën për të cilën është kërkuar si ekspert.**

Në CV, për periudhën **01.06.2016 – vazhdoj**, z. Hamiti figuron në pozitën **“Menaxher Ekzekutiv”**. Detyrat e paraqitura në CV kanë të bëjnë kryesisht me hartimin e politikave të kompanisë, planifikimin e operimit, ndarjen e përgjegjësisë ndërmjet sektorëve, angazhimin e personelit, politikat e shitjes, marrëveshjet me klientë dhe furnitorë, menaxhimin e transaksioneve dhe përpilimin e raporteve.

Pra, CV-ja dëshmon **punësim**, por nuk e identifikon këtë periudhë si ushtrim të detyrës së **Ekspertit për Siguri dhe Shëndet në Punë**.

Fakti se punëdhënësi NMA SH.P.K është kompani e licencuar për Siguri dhe Shëndet në Punë nuk është i barabartë me dëshminë se z. Hamiti, gjatë gjithë periudhës së punësimit si Menaxher Ekzekutiv, ka ushtruar funksionin profesional të ekspertit të certifikuar. Veprimtaria e kompanisë dhe përvoja individuale profesionale e një personi janë dy çështje të ndryshme.

Kjo mbështetet edhe nga **referenca e dorëzuar posaçërisht për z. Hamiti**, në të cilën ai identifikohet shprehimisht si **Ekspert për Siguri dhe Shëndet në Punë i certifikuar nga MPMS**. Në këtë referencë janë paraqitur angazhimet konkrete në këtë cilësi, përfshirë periudhën 25.01.2020–20.12.2020 dhe angazhimet nga 13.06.2023 deri më 05.02.2026.

Duke mos i numëruar dy herë periudhat që mbivendosen, këto angazhime dokumentojnë afërsisht **3 vite e 7 muaj përvojë të identifikuar konkretisht në cilësinë e Ekspertit për Siguri dhe Shëndet në Punë**, dhe jo minimumin prej **5 viteve** të kërkuara nga AK.

Kërkesa e AK-së nuk mund të interpretohet e shkëputur nga vetë pozita për të cilën është vendosur. AK nuk ka kërkuar thjesht një person të certifikuar që, pas certifikimit, ka qenë i punësuar diku për pesë vite; ka kërkuar një **Ekspert për Siguri dhe Shëndet në Punë**, të certifikuar nga MPMS, **me përvojë pune minimum pesë vite pas certifikimit**. Në kontekstin e kriterit të aftësisë teknike dhe profesionale, përvoja duhet të jetë e lidhur me kapacitetin profesional për të cilin personi propozohet. Neni 69 i LPP-së pikërisht kërkon që OE të dëshmojë posedimin e kualifikimeve minimale të specifikuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë.

Në të kundërtën, do të mjaftonte çfarëdo punësimi pas datës së certifikimit, pavarësisht natyrës së punës, gjë që do ta bënte kriterin e përvojës profesionale të ekspertit praktikisht pa efekt.

OE fitues nuk ka dëshmuar minimum pesë (5) vite përvojë pune profesionale pas certifikimit të z. Muhamet Hamiti në cilësinë e Ekspertit për Siguri dhe Shëndet në Punë të certifikuar nga MPMS. CV-ja e paraqet atë si Menaxher Ekzekutiv, ndërsa referenca që dëshmon konkretisht angazhimin e tij si ekspert në këtë fushë nuk arrin periudhën minimale prej pesë viteve të kërkuar nga AK.

Kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që këtë pretendim ta pranojë si të bazuar,

Pretendimi Nr. 11

AK ka bërë vlerësim jo të plotë të Kërkesës nr. 8, pasi OE AGE GROUP SH.P.K. nuk ka dorëzuar Listën e Pajisjeve sipas Aneksit nr. 7, ndërsa kjo mungesë nuk është evidentuar

dhe trajtuar gjatë procesit të vlerësimit.

Autoriteti Kontraktues, në kuadër të kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional, me **Kërkesën nr. 8** ka përcaktuar shprehimisht:

“Operatori Ekonomik duhet të ketë një Listë për pajisjet-mjetet stabilimentet që ka në dispozicion për realizimin e projektit sipas Aneksit 7.”

Ndërsa në **Aneksin nr. 7 – Lista e Pajisjeve**, për LOT 1 janë përcaktuar pajisjet konkrete, sasia minimale e kërkuar dhe rubrika **“Sasia që ofron ofertuesi”**, përkatësisht: kamioneta me lift 850 kg, kamioneta me vinç deri në 600 kg, mini-ekskavatori minimum 1 ton dhe kamera inspektuese 23 mm me kabllo 30 m.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga **AGE GROUP SH.P.K.**, rezulton se ky OE ka dorëzuar dokumente individuale lidhur me disa pajisje, si libreza regjistrimi, marrëveshje për shfrytëzim, dokumente doganore dhe fatura. Megjithatë, **nuk rezulton e dorëzuar dhe e plotësuar Lista e Pajisjeve sipas Aneksit nr. 7**, ashtu siç është kërkuar shprehimisht nga AK. Dokumenti “Paisjet.pdf” përmban këto dëshmi individuale, por jo Aneksin nr. 7 të plotësuar nga AGE GROUP SH.P.K.

Kjo mangësi është edhe më relevante sepse **Dëshmia nr. 8** përcakton jo vetëm mënyrën e dëshmimit të pronësisë apo shfrytëzimit të pajisjeve, por kërkon shprehimisht që dëshmitë **“të ofrohen të renditura sipas listës së bashkangjitur në Aneksin 7”**, si dhe të jepen karakteristikat, specifikat teknike, kapaciteti dhe të dhënat e nevojshme për evidentimin e saktë të secilës pajisje.

Prandaj, **dorëzimi i dokumenteve të veçanta për pajisjet nuk nënkupton se OE e ka dorëzuar edhe dokumentin e kërkuar – Listën e Pajisjeve sipas Aneksit nr. 7.**

Në këtë pikë, pretendimi ynë **nuk mbështetet në qëndrimin se AGE GROUP SH.P.K. domosdoshmërisht duhej eliminuar automatikisht pa kërkuar sqarime** vetëm për mungesën e listës.

Sipas **Nenit 72 të LPP-së**, kur dokumentacioni është ose duket i paplotë, apo kur mungojnë dokumente specifike, AK mund të kërkojë nga OE që t'i plotësojë, sqarojë apo kompletojë dokumentet, me kusht që dokumenti ose informacioni që plotësohet t'i referohet një gjendjeje ekzistuese para afatit për dorëzim të tenderëve dhe kjo të mund të verifikohet objektivisht.

Edhe **Udhëzuesi për Prokurimin Publik** parashikon, në një rast analog, se kur **lista e kontratave nuk është dorëzuar, por janë dorëzuar dëshmitë përkatëse**, mund të kërkohej informata sqaruese.

Mirëpo, kjo **nuk nënkupton se AK mund ta konsiderojë automatikisht dokumentin e munguar si të dorëzuar.**

Nëse AK ka konsideruar se dokumentacioni tjetër i AGE GROUP SH.P.K. ishte i mjaftueshëm për të mundësuar plotësimin apo sqarimin e Aneksit nr. 7, atëherë kjo mangësi është dashur të evidentohet dhe të trajtohet në kuadër të procedurës së sqarimit/plotësimit sipas Nenit 72 të LPP-së.

Në të kundërtën, **konsiderimi i Kërkesës nr. 8 si të përmbushur, pa qenë e dorëzuar Lista e Pajisjeve e kërkuar shprehimisht nga Dosja e Tenderit dhe pa u trajtuar kjo mungesë,**

përbën vlerësim jo të plotë dhe jo konsistent me kërkesat e përcaktuara nga vetë AK.

LPP përcakton se tenderi konsiderohet i përgjegjshëm vetëm kur është në pajtueshmëri me kërkesat e Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit, përveç gabimeve, paqartësive apo devijimeve të vogla që mund të trajtohen në përputhje me dispozitat përkatëse.

Kërkesë ndaj Autoritetit Kontraktues

Duke u bazuar në faktet dhe provat e paraqitura më sipër, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që Pretendimin tonë ta aprovojë si të bazuar.

Pretendimi Nr. 12

– Kamioneta me lift me peshë maksimale të ngarkesës 850 kg

AK ka konsideruar të përmbushur kërkesën për “Kamionetë me lift me peshë maksimale të ngarkesës 850 kg”, mirëpo nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për qasje nuk është e mundur të verifikohet karakteristika teknike vendimtare prej 850 kg, pasi në versionin e pastruar të Certifikatës së Regjistrimit janë mbuluar pikërisht të dhënat relevante lidhur me peshën/masën e automjetit.

Autoriteti Kontraktues në Aneksin nr. 7 ka kërkuar shprehimisht:

“Kamionetë me lift me peshë maksimale të ngarkesës 850 kg” – 1 copë, me regjistrim valid.

Sipas Dëshmisë nr. 8, OE është obliguar që për pajisjet e paraqitura të ofrojë karakteristikat, specifikat teknike, kapacitetin dhe të dhënat e tjera të nevojshme për identifikimin dhe verifikimin e saktë të pajisjes.

AGE GROUP SH.P.K. ka paraqitur Certifikatë të Regjistrimit për automjetin IVECO. Nga dokumenti i dhënë për qasje mund të identifikohet automjeti dhe te rubrika 2A evidentohet përshkrimi **“KAMIONETË ME LIFT”**. Megjithatë, në faqen që përmban të dhënat teknike janë mbuluar me ngjyrë të zezë, ndër të tjera, rubrikat **F, F.1 dhe G**, të cilat lidhen me masën/peshën e automjetit dhe janë relevante për verifikimin e kapacitetit të ngarkesës.



A	Niveli i regjistrimit: Spjeli përkatësorjeje Registration number:	07-466-EG
I	Data e regjistrimit: Datumi përkatësorjeje Date of registration:	21.03.2023
C	Titulli i personit: Titulli i personit Personal data:	
C.2	Prodhues i automjetit: Prodhues i automjetit Manufacturer of the vehicle:	
C.2.1	Motoni dhe grupi i biznesit: Prodhuesi dhe grupi i biznesit Manufacturer and business group:	AGE Group SH.PK
C.2.2	Emri: Emri Name:	
C.2.3	Adresa: Adresa Address:	
B	Data e regjistrimit të parë: Datumi i parë regjistrimi Date of first registration:	24.07.2001
D	Automjeti: Automjeti Vehicle:	
D.1	Prodhuesi: Prodhuesi Manufacturer:	IVECO
D.2	Tipi: Tipi Type:	
D3	Përshkrimet komerciale: Komerciale përshkrimet Commercial descriptions:	DAILY
E	Niveli i identifikimit: Niveli i identifikimit Identification level:	
S	Viti i prodhimit: Viti i prodhimit Year of production:	2001
S	Kapaciteti i ulësve: Kapaciteti i ulësve Seating capacity:	
S.1	Niveli i ulësve: Niveli i ulësve Number of seats:	
S.2	Niveli i vendit për qëndrim: Niveli i vendit për qëndrim Number of standing places:	
Q	Raporti Peshë/Potential (në kV/kV): Raporti Peshë/Potential (në kV/kV) Power/Weight ratio (in kW/kV):	
F	Peshë: Peshë Mass:	
F1	Peshë maksimale e ngarkesës së lehtë: Peshë maksimale e ngarkesës së lehtë Maximum permissible laden mass:	
G	Peshë e automjetit: Peshë e automjetit Mass of the vehicle:	
K	Homologimi: Homologimi Type of approval:	
P	Motoni: Motoni Engine:	
P1	Kapaciteti i ndalimit: Kapaciteti i ndalimit Capacity (in m³):	2800
P2	Peshë maksimale neto (në kV): Peshë maksimale neto (në kV) Maximum net power (in kW):	78,00
P3	Lloji i karbësimit ose burimit të energjisë: Lloji i karbësimit ose burimit të energjisë Type of fuel or power source:	Dizel - EURO 3
R	Niveli i identifikimit: Niveli i identifikimit Color of the vehicle:	X - SHUMËNGJYRËSH
2A	Niveli i identifikimit: Niveli i identifikimit Construction:	KAMIONETË ME LIFT me 2 dyer
	Shënime: Shënime Remarks:	

Për rrjedhojë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion palës së interesuar nuk mund të verifikohet nëse automjeti i ofruar e plotëson kërkesën konkrete prej 850 kg. Vetë fakti që dokumenti dëshmon se automjeti është “kamionetë me lift” nuk provon edhe përmbushjen e parametrave të veçantë sasior prej 850 kg.

Sipas nenit 59.4 të LPP-së, një tender mund të konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Po ashtu, neni 40.6 i Rregullores nr. 001/2022 përcakton se tenderi është i përgjegjshëm vetëm kur, ndër të tjera, është në pajtueshmëri teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e dosjes së tenderit. Prandaj, përmbushja e kriterit nuk mund të prezumohet; ajo duhet të jetë e verifikueshme mbi bazën e provave të tenderit ose të dokumenteve/sqarimeve të lejueshme sipas LPP-së.

Në të njëjtën kohë, ligjshmëria e redaktimit të këtyre të dhënave është e kontestueshme. Neni 11.3 i LPP-së kërkon që klasifikimi si sekret afarist të mbështetet në kërkesë konkrete dhe në arsye që demonstrojnë bindshëm dëmin material që do t'i shkaktonte interesave legjitime

komerciale të operatorit ekonomik. Rregullorja nr. 001/2022 kërkon që në Aneksin 3 të jepet **arsyetimi për secilin dokument të identifikuar si sekret afarist**. Për më tepër, neni 7.6.1, i shtuar me Rregulloren nr. 002/2024, ndalon AK-në të klasifikojë informatën si sekret afarist kur Aneksi 3 nuk përmban të gjitha informacionet, faktet dhe argumentet që dëshmojnë se publikimi do t'i shkaktojë OE-së dëm material.

Nëse Aneksi nr. 3 i AGE GROUP SH.P.K. nuk identifikon konkretisht Certifikatën e Regjistrimit, rubrikat teknike që kërkohet të mbahen sekrete dhe faktet konkrete që demonstrojnë dëmin material nga zbulimi i tyre, atëherë referimi i përgjithshëm në nenet 68 dhe 69 të LPP-së nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar klasifikimin dhe redaktimin e këtyre të dhënave.

Për më tepër, LPP obligon AK-në që palës së interesuar t'i sigurojë qasje të arsyeshme në dokumentacionin e aktivitetit, me përjashtim vetëm të informatave që janë **vërtetuar në mënyrë të ligjshme** si sekrete afariste. Edhe Rregullorja nr. 002/2024 kërkon që versionin e pastruar të përgatitet sipas nenit 11.4 të LPP-së dhe, pas B58, t'i ofrohet menjëherë palës që kërkon qasje.

Për këto arsye kërkojmë që Pretendimi të aprovohet si i bazuar

Pretendimi Nr. 13

– Kamionetë me vinç, pesha e ngarkesës deri në 600 kg

AK ka konsideruar të përmbushur kërkesën për kamionetë me vinç me peshë të ngarkesës deri në 600 kg, ndërsa nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për qasje nuk mund të verifikohet objektivisht karakteristika teknike prej 600 kg, pasi të dhënat relevante të Certifikatës së Regjistrimit janë mbuluar me ngjyrë të zezë.

AGE GROUP SH.P.K. ka paraqitur **Marrëveshje bashkëpunimi për përkrahje me makineri** të lidhur me personin fizik Menan Shehu, në të cilën pajisja është përshkruar shprehimisht:

“Kamionetë me vinç pesha e ngarkesës deri në 600kg” – 1 copë.

Për këtë pajisje është paraqitur Certifikatë e Regjistrimit për automjet IVECO. Nga dokumenti mund të identifikohet lloji i mjetit dhe në rubrikën 2A evidentohet përshkrimi **“Kamionetë me vinç mbi 2 dyer”**. Mirëpo, në faqen me të dhënat teknike, rubrikat që lidhen me peshën/masën e automjetit, përfshirë **F, F.1 dhe G**, janë mbuluar me ngjyrë të zezë.



A	Niveli i regjistrimit: Ipis per regjistrim: Registration number:	07-781-FE
1	Data e regjistrimit: Data per regjistrim: Registration date:	01.07.2024
C	Të dhëna personale: Personal data:	
C.2	Proprari i mjeteve: Bazuar në bazën e të dhënave: Owner of the vehicle:	Shehu
C.2.1	Mbështetësi ose entitet i biznesit: Përkrahësi i biznesit ose entiteti: Sponsor or business name:	Monan
C.2.2	Emri: Name:	
C.2.3	Adresa: Address:	
B	Data e regjistrimit të parë: Data e parë të regjistrimit: Date of first registration:	28.06.2007
D	Automjeti: Vehicle:	
D.1	Prodhuesi: Manufacturer:	IVECO
D.2	Tipi: Type:	
D3	Përshkrimi i kontejnerit: Description of container:	
E	Niveli i identifikimit të automjetit: Identifikimi i automjetit: Identification of the vehicle:	
S	Viti i prodhimit: Year of production:	2007
S	Kapaciteti i motorit: Motor capacity:	
S.1	Niveli i identifikimit të motorit: Identification of the motor:	
S.2	Niveli i identifikimit të motorit: Identification of the motor:	
Q	Raporti i peshës (kg): Weight ratio (kg):	
F	Peshë: Weight:	
F.1	Peshë maksimale e pajisjes së motorit: Maximum weight of the motor equipment:	
G	Peshë maksimale e pajisjes së motorit: Maximum weight of the motor equipment:	
K	Përshkrimi i kontejnerit: Description of container:	
P	Motori: Engine:	
P.1	Kapaciteti (në cm³): Capacity (in cm³):	2968
P.2	Pesha maksimale neto (në kW): Maximum net power (in kW):	107,00
P.3	Lloji i karburantit të burimit të energjisë: Type of fuel or power source:	Dizel
R	Niveli i identifikimit të automjetit: Identification of the vehicle:	X - SHUMËNGJYRESH
2A	Niveli i identifikimit të automjetit: Identification of the vehicle:	Kamionetë me vinq me 2 dër

Pra, dokumentacioni i dhënë për qasje dëshmon vetëm se bëhet fjalë për **kamionetë me vinq**, por nuk mundëson të verifikohet karakteristika sasiore konkrete prej **600 kg**. Ekzistenca e vinqit dhe kapaciteti i tij/ngarkesa e lejuar janë dy çështje të ndryshme dhe përmbushja e së parës nuk mund të merret automatikisht si provë e së dytës.

Sipas nenit 59.4 të LPP-së, tenderi konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Po ashtu, neni 40.6 i Rregullores nr. 001/2022 kërkon pajtueshmëri teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosjen e tenderit.

Problematik është gjithashtu klasifikimi i këtyre të dhënave si sekret afarist. Neni 11.3 i LPP-së lejon klasifikimin vetëm kur OE ka paraqitur kërkesë konkrete dhe arsye që demonstrojnë bindshëm se publikimi do të shkaktonte dëm material të interesave legjitime komerciale. Sipas nenit 7.6.1 të Rregullores nr. 002/2024, AK **nuk do ta klasifikojë informatën si sekret afarist** nëse Aneksi 3 nuk përmban të gjitha faktet dhe argumentet që dëshmojnë dëmin material.

Shkeljet e AK-së: AK ka konsideruar të përmbushur një karakteristikë teknike të matshme prej 600 kg, ndërsa në dokumentacionin e qasjes ka mbuluar pikërisht të dhënat që do të mundësonin kontrollimin e këtij konstatimi. Nëse Aneksi nr. 3 nuk individualizon konkretisht këto rubrika dhe nuk arsyeton dëmin material nga publikimi i tyre, redaktimi është i pajustificuar.

Kërkojmë që Pretendimi të aprovohet si i bazuar

Pretendimi Nr. 14

– **Mini-eskavatori – mbulimi i karakteristikës teknike dhe pamundësia e identifikimit të pajisjes**

AK ka konsideruar të përmbushur kërkesën lidhur me mini-eskavatorin, ndërsa dokumentacioni i dhënë për qasje nuk mundëson verifikimin e plotë as të karakteristikës teknike të pajisjes, as lidhjen e sigurt ndërmjet mini-eskavatorit të dhënë në shfrytëzim dhe dokumentacionit doganor të paraqitur si dëshmi.

AGE GROUP SH.P.K. ka paraqitur **Marrëveshje bashkëpunimi me ETEAM SH.P.K.**, sipas së cilës ETEAM ia jep AGE GROUP SH.P.K. në shfrytëzim një **“Mini eskavator ...” – 1 copë**. Mirëpo, menjëherë pas emërimit “Mini eskavator”, pjesa ku ndodhet karakteristika/përshkrimi i mëtejshëm i pajisjes është **mbuluar me ngjyrë të zezë** në dokumentin e dhënë për qasje. Marrëveshja është e datës 24.06.2026.

Në vazhdim është paraqitur Dokumenti Unik Doganor në emër të ETEAM SH.P.K., ku evidentohet importimi i **1 mini-eskavatori të ri** dhe shënohen disa karakteristika teknike. Megjithatë, edhe në këtë dokument janë mbuluar të dhëna identifikuese dhe teknike, ndër të tjera pjesë të përshkrimit dhe numri serik/identifikues i pajisjes.

Dokument i Unik Doganor

ZYRA E DESTINIMIT

2 Eksportuesi TRANSACTIONS NETHERLANDS BV 1016 BC AMSTERDAM		3 OPERARAT 1/1/1		2020 ZOO PRISHTINE Referenca doganore [Redacted] Manifesti 2024 36881	
8 Marrësi i Importuesit ETEAM SH.P.K. Rr Llapit, pu Obiliq		9 Personi përgjegjës ETEAM SH.P.K. Rr Llapit, pu Obiliq		10 Vendi XK [Redacted]	
14 Deklaruesi SKY LOGISTIC L.L.C. Rr.LIDHJA E PEJES Nr. 10 PRISHTINE		15 Vendi dërgues/skapertues HOLANDA		16 Vendi origjinal KINA	
18 Identifikuesi dhe nacionaliteti i njeriut transportues në VR160TV AD034VR XS NO		19 Kushtet e dërgesës EXW AMSTERDAM		20 Kushtet e dërgesës EXW AMSTERDAM	
21 Identifikuesi dhe nacionaliteti i mjeteve të transportues që kalon VR160TV AD034VR		22 Valuta dhe shuma e EUR 4,500.00		23 Kursi i 1.0000000	
24 Lloji 30 [Redacted]		25 Lloji 30 Transport		26 Të dhëna financiare dhe bankore Kushtet e	
27 Zyre doganore hyrëse/delase 3041 P-K DHEU I BARDHË		28 Lokacioni i mallrave		29 Artikulli 1 No	
31 Paketi dhe përshkrimi i mallit Shtesat dhe numrat - Nr i kontenerit - Numri dhe tip Shtesat dhe nr Kontener Numri dhe 1 PC Lloji Pako Makinieritë me rrotullim të superstrukturës 360°, eskavatorët track - Mini-eskavator i ri-typ [Redacted] Viti 2024, Diesel, Cilësia 2300mm, Motori 8.2kW, Nr. Ser. [Redacted] Rrëse: 1, Ngjyra e kuqe.		32 Numri tarifor 00		33 Kodi origjinës a CN b [Redacted]	
41 Inf. Dokumenti Certifikata dhe Autorizimi Nr. Licencës D.Via. D.Sae 640.00+0.00+0.00+2,100.55-3.00 D. 380 Dërgesa 1/6		42 Niveli për njësi 4,500.00		43 M.V. 1 kod	
47 Llog. Teksteve të kësht Lloji Baza e teksteve Norma Shuma M CD 7,240.550 0.000 0.00 1 VT 7,240.550 18.000 1,303.30 1		48 Llogaritja e pagosës 0 DETAJET E LLOGARITJES Mënyra e pagosës KESH Numri i Pranimit f Data Numri i Pagosës Data Garancioni 0.00 EUR Data Totali 0.00 EUR Totali i teksteve 1,303.30 EUR		49 Identifikuesi i depoz 7,240.55	
50 Principali Nr Nënshkrimi		C ZYRA E NISJES			
51 Zyre zyrtare të transhimit Përfaqësuar nga: Vendi dhe data:		52 nuk vlen			
53 Zyre e destinacionit dhe vendi Kodi		54 Vendi dhe data			
D KONTROLLI NGA ZYRA DOBANORE E DESTINACIONIT		Vlerat:		Deklaruesi emri / përfaqësuesi VLORA MALIQI VM0384	

Nënshkrimi: _____

Seals: _____

Kjo krijon dy probleme të veçanta.

Së pari, **pala e interesuar nuk mund të dijë se çfarë karakteristike konkrete është deklaruar në Marrëveshjen e bashkëpunimit**, sepse pikërisht pjesa pas fjalëve “Mini eskavator” është redaktuar.

Së dyti, për shkak të mbulimit të të dhënave identifikuese, **nuk mund të bëhet lidhja objektive**

ndërmjet pajisjes së përmendur në Marrëveshje dhe mini-eskavatorit të paraqitur në Dokumentin Unik Doganor. Fakti që ETEAM ka importuar një mini-eskavator nuk është vetvetiu i mjaftueshëm për të provuar se ai është pikërisht pajisja që është vënë në dispozicion të AGE GROUP SH.P.K. dhe që plotëson parametrat konkretë të kërkuar në dosjen e tenderit.

Kjo është posaçërisht e rëndësishme sepse neni 69 i LPP-së parashikon që OE duhet të sigurojë dëshmi që tregojnë se i posedon kualifikimet dhe aftësitë teknike minimale të kërkuara. Për kontratat e punëve, ligji lejon të kërkohej raporti për **mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë në dispozicion të OE-së për realizimin e projektit.**

Kur OE mbështetet në kapacitetet e një subjekti tjetër, LPP kërkon që ai të dëshmojë se **do t'i ketë në dispozicion burimet e nevojshme për ekzekutimin e kontratës.** Pra, nuk mjafton vetëm ekzistenca teorike e një mini-eskavatori te subjekti tjetër; duhet të provohet pajisja konkrete dhe disponueshmëria e saj për kontratën konkrete.

Edhe për këtë pajisje zbatohet neni 7.6.1 i Rregullores nr. 002/2024: nëse OE nuk ka identifikuar në Aneksin nr. 3 konkretisht informatën e mbuluar dhe nuk ka paraqitur faktet dhe argumentet që provojnë dëmin material, AK nuk ka bazë për ta klasifikuar atë si sekret afarist.

Shkeljet e AK-së: AK ka pranuar si të mjaftueshëm dokumentacion në të cilin karakteristika e mini-eskavatorit në Marrëveshjen e bashkëpunimit është mbuluar, ndërsa edhe të dhënat që do të mundësonin identifikimin dhe lidhjen e pajisjes me dokumentin doganor janë redaktuar. Si rezultat, nuk mund të kontrollohet objektivisht nëse pajisja konkrete e vënë në dispozicion është ajo që plotëson kërkesën e dosjes së tenderit.

Kërkojmë që Pretendimi të aprovohet si i bazuar

Pretendimi Nr. 15

– Kamera inspektuese për tuba të kanalizimit: pamundësia e verifikimit për shkak të mbulimit të të dhënave identifikuese në DUD

AK ka konsideruar të përmbushur kërkesën për pajisjen – kamerë inspektuese për tuba të kanalizimit – ndërsa në Dokumentin Unik Doganor të vënë në dispozicion për qasje ka mbuluar me ngjyrë të zezë të dhëna relevante identifikuese të pajisjes, duke pamundësuar verifikimin objektiv të pajisjes konkrete mbi të cilën është bazuar vlerësimi.

Nga Dokumenti Unik Doganor në emër të **KOREKT COMPANY LLC** evidentohet importimi i një pajisjeje të përshkruar si:

“Kamerë inspektuese për tuba të kanalizimit 23 mm, me kabllo 30 m; Drain/Pipe/Video; Nr. serik: ...” – 1 copë.

Mirëpo, pikërisht pas rubrikës **“Nr. serik”**, e dhëna identifikuese është mbuluar me ngjyrë të zezë nga AK. Për rrjedhojë, nga dokumentacioni i dhënë për qasje **nuk mund të identifikohet numri serik i kamerës dhe nuk mund të verifikohet në mënyrë të pavarur se cila pajisje konkrete është paraqitur si dëshmi për përmbushjen e kërkesës së Dosjes së Tenderit.**

7 Eksportuesi KOREKT COMPANY D.O.O. RANKA TAJICA 5 KURZIN PUT 75 11000 BEOGRAD		1 DEKLARATE IM 4 2042 VERMICA TERMINALI Referenca doganore																																			
8 Marrësi / Importuesi KOREKT Company L.L.C. Rruga Hilmi Maliqi, pr Rahovec		3 Formulari 1 2 4 R Manifesti 2024 4384																																			
14 Dëshmorësi TREXIM L.L.C. DËSHMORËT E VËRMICËS PRIZREN		5 Emërtimi 3 6 Nr. pakove 1 7 Numri referues 2024 #160																																			
18 Identiteti dhe nacionaliteti i tijve të transportues në dalje të tijve		9 Personi përgjegjës financiar KOREKT Company L.L.C. Rruga Hilmi Maliqi, pr Rahovec																																			
21 Identiteti dhe nacionaliteti i tijve të aktiv transportues në kalan kufitare		10 Vendi XK 11 Vendi i XS 12 Detajet e vlerës 100.00 13 P.P.B. 0																																			
25 Lloji transporti 30 Në kufi 30 Transport		15 Vendi dërgues/eksportues SERBIA 16 Vendi origjinës SHUME 17 Vendi i destinacionit KOSOVA																																			
29 Zyra doganore hyrëse/njësore 3024 PKK JARINJE		28 Kushtet e dërgesë FXW BEOGRAD, XS 22 Vlera dhe shuma e përgjithshme EUR 2,770.75 23 Kursi i këmbimit 1.0000000 24 Lloji i transaks. 1																																			
31 Pakëtimet dhe përshkrimet e mallit		32 Artikulli 1 33 Numri i tijve 00																																			
34 Kodi origjinës a NL b 35 Pesha bruto (kg) 4000 36 Preferenca 37 Procedura 4000 38 Pesha Net (kg) 39 Kuota 40 Dokumenti parapërkohës, përmbledhës S/L 1		41 Njësia plotësuese PCE 1.00 42 Çmimi për njësi 1,348.07 43 M.V. 1 44 Rregullimi 1.000 45 Vlera Statistike 1,396.72																																			
47 Llogaritja e taksave		48 Llogaritja e pagesës																																			
<table border="1"> <thead> <tr> <th>Lloji</th> <th>Baza e taksës</th> <th>Norma</th> <th>Shuma</th> <th>BP</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>CD</td> <td>1,396.720</td> <td>10.000</td> <td>139.67</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>VT</td> <td>1,536.390</td> <td>18.000</td> <td>276.55</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td colspan="3">Totali</td> <td>416.22</td> <td>1</td> </tr> </tbody> </table>		Lloji	Baza e taksës	Norma	Shuma	BP	CD	1,396.720	10.000	139.67	1	VT	1,536.390	18.000	276.55	1	Totali			416.22	1	<table border="1"> <thead> <tr> <th colspan="2">B DETAJET E LLOGARITJES</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Mënyra e pagesës</td> <td>KESH</td> </tr> <tr> <td>Numri i Pranimt</td> <td>L 10770 / Data 08/04/2024</td> </tr> <tr> <td>Numri Pagesës</td> <td>P 4943 / Data 08/04/2024</td> </tr> <tr> <td>Garancioni</td> <td>0.00 EUR Data</td> </tr> <tr> <td>Totali shërbimeve</td> <td>0.00 EUR</td> </tr> <tr> <td>Totali taksave</td> <td>855.47 EUR</td> </tr> </tbody> </table>		B DETAJET E LLOGARITJES		Mënyra e pagesës	KESH	Numri i Pranimt	L 10770 / Data 08/04/2024	Numri Pagesës	P 4943 / Data 08/04/2024	Garancioni	0.00 EUR Data	Totali shërbimeve	0.00 EUR	Totali taksave	855.47 EUR
Lloji	Baza e taksës	Norma	Shuma	BP																																	
CD	1,396.720	10.000	139.67	1																																	
VT	1,536.390	18.000	276.55	1																																	
Totali			416.22	1																																	
B DETAJET E LLOGARITJES																																					
Mënyra e pagesës	KESH																																				
Numri i Pranimt	L 10770 / Data 08/04/2024																																				
Numri Pagesës	P 4943 / Data 08/04/2024																																				
Garancioni	0.00 EUR Data																																				
Totali shërbimeve	0.00 EUR																																				
Totali taksave	855.47 EUR																																				
50 Principali		51 Zyra zyrtare																																			
52 Garancioni		53 Zyra e destinacionit dhe vendi																																			
D KONTROLLI NGA ZYRA DOKANDRE E DESTINACIONIT		54 Vendi dhe data																																			
Nënshkrimi		Deklaruesi emri / përfaqësuesi																																			
Sealja		ARLIND MICAJ AM4688																																			

Numri serik nuk është një e dhënë pa rëndësi. Ai është element individualizues që mundëson lidhjen e dokumentit doganor me **pajisjen konkrete**. Kur kjo e dhënë mbulohet, pala e

interesuar nuk mund të verifikojë nëse kamera e paraqitur në DUD është e njëjta pajisje që OE pretendon se e ka në dispozicion për realizimin e kontratës dhe nëse dokumentacioni i paraqitur në pjesë të ndryshme të ofertës i referohet të njëjtës pajisje.

Pra, nga versioni i dokumentacionit të vënë në dispozicion mund të konstatohet vetëm se KOREKT COMPANY LLC ka një dokument doganor ku përshkruhet **një kamerë inspektuese 23 mm me kablo 30 m, por nuk mund të kontrollohet identiteti individual i saj, sepse AK ka redaktuar pikërisht numrin serik.**

Kjo është veçanërisht problematike nëse AK është mbështetur në versionin e plotë të DUD-it për të konstatuar se kërkesa është përmbushur, ndërsa palës së interesuar i është ofruar një version në të cilin është hequr elementi që mundëson verifikimin dhe gjurmueshmërinë e pajisjes.

Sipas nenit 11.3 të LPP-së, një informatë mund të klasifikohet si sekret afarist vetëm nëse plotësohen kushtet ligjore, përfshirë kërkesën konkrete të operatorit ekonomik dhe arsyet që demonstrojnë bindshëm se qasja publike në informatën përkatëse do të shkaktonte dëm material ndaj interesave legjitime komerciale të tij.

Po ashtu, neni 7.6.1 i Rregullores nr. 002/2024 përcakton shprehimisht se **Autoriteti Kontraktues nuk do ta klasifikojë informatën si sekret afarist nëse OE nuk e ka plotësuar Aneksin nr. 3 me të gjitha informacionet, faktet dhe argumentet me të cilat dëshmon se zbulimi i informatës do t'i shkaktojë dëm material biznesit të tij.**

Rregullorja nr. 001/2022 kërkon gjithashtu që OE të japë në Aneksin nr. 3 **arsyetimin për secilin dokument të identifikuar si sekret afarist**, dhe jo vetëm një referim të përgjithshëm në nenet 68 dhe 69 të LPP-së.

Për më tepër, Rregullorja nr. 002/2024 sqaron se **jo të gjitha dokumentet apo informatat që lidhen me aftësinë teknike dhe profesionale mund të klasifikohen automatikisht si sekret afarist.**

Shkeljet e AK-së: AK ka konsideruar të dëshmuar pajisjen konkrete, ndërsa në dokumentin kryesor të paraqitur për identifikimin e saj ka mbuluar numrin serik dhe të dhëna të tjera të redaktuara. Si rezultat, pala e interesuar nuk mund të kontrollojë identitetin dhe gjurmueshmërinë e kamerës së paraqitur, as të verifikojë nëse dokumentet e tjera të ofertës i referohen pikërisht të njëjtës pajisje. Nëse Aneksi nr. 3 nuk e identifikon konkretisht DUD-in dhe numrin serik si informatë sekrete dhe nuk përmban argumente konkrete për dëmin material që do të shkaktonte publikimi i tij, redaktimi i kësaj të dhëne nuk është i arsyetuar sipas kërkesave të LPP-së dhe Rregullores.

Kërkojmë që ky Pretendim të aprovohet si i bazuar,

Pretendimi Nr. 16

Autoriteti Kontraktues në **Kërkesën 8/Dëshminë 8** ka përcaktuar shprehimisht se, në rast se OE nuk i posedon pajisjet në pronësi, duhet të paraqesë marrëveshjen për marrjen me qira/shfrytëzim, e cila duhet të jetë në emër të projektit **dhe me validitet të kohëzgjatjes së kontratës. Kohëzgjatja e kontratës është përcaktuar 24 muaj.**

Për pajisjen **Kamionetë me vinç, pesha e ngarkesës deri në 600 kg, 1 copë**, OE ka paraqitur marrëveshje me Menan Shehun, në të cilën thuhet se pajisja jepet në shfrytëzim për

realizimin e projektit.

Mirëpo, marrëveshja nuk përcakton se është valide për **24 muaj**, as se do të jetë valide **deri në përfundimin e projektit apo gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës**. Nga pjesa përfundimtare e marrëveshjes shihet vetëm data e nënshkrimit, 26.06.2026, por nuk përcaktohet afati i vlefshmërisë së saj.

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI PËR PËRKRAHJE ME MAKINERI

Kjo marrëveshje lidhe për Projektin: **Rregullimi i Qendrës së Kulturës Aneksi A&B (LLOT 1); Rregullimi i nyjeve sanitare në Qendrën e Kulturës, Palestrën Sportive dhe në Muzeun e Qytetit (LLOT 2)**
642-26-4255-5-2-1

Në mes të **personit fizik Menan Shehu** adresa Rr Xhelal Hajda Toni pn Rahovec

Kompanisë "**AGE group Sh.p.k** nr.unik:810733685 adresa: Rr.Uçk-së p.n Rahovec të cilën e përfaqëson z.Tahir Bala Drejtor Ligjor, dhe

Neni 1

Menan Shehu ne baze te kesaj marreveshje i jep ne shfrytezim kompanise **AGE group Sh.p.k** makinerine e punes per realizimin e projektit: **Rregullimi i Qendrës së Kulturës Aneksi A&B (LLOT 1); Rregullimi i nyjeve sanitare në Qendrën e Kulturës, Palestrën Sportive dhe në Muzeun e Qytetit (LLOT 2)**
642-26-4255-5-2-1 i brendshëm 623-26-006-1-1-1

Nr.	Lloji i mjetit	Njësia	Sasia
1.	Kamionetë me vinç pesha e ngarkesës deri ne 600kg	Copë	1

Neni 2

Cmimi për furnizime dhe shërbime caktohet me aneks kontratë

Neni 3

Në rast kontesti lidhur me objektin e marrëveshjes në fjalë, kompetente është Gjykata Komunale në Prishtinë.

Neni 4

Palët e nënshkruajnë këtë marrëveshje në pajtim të plotë në mes tyre.

Neni 5

Kjo marrëveshje përpilohet në 4 (katër) kopje identike dhe nga 2 (dy) kopje i marrin palët e kësaj marrëveshje

Nënshkruesit e marrëveshjes:

Menan Shehu



26.06.2026

AGE group Sh.p.k



OE, rrjedhimisht, **nuk ka dëshmuar se marrëveshja për pajisjen në fjalë është valide për periudhën 24-mujore të kontratës, përkatësisht deri në përfundimin e projektit.** Formulimi se pajisja jepet “për realizimin e projektit” tregon vetëm qëllimin e përdorimit të saj, por nuk përcakton kohëzgjatjen e vlefshmërisë së marrëveshjes. Për rrjedhojë, nuk është dëshmuar se pajisja do të jetë në dispozicion të OE-së gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

Në këto rrethana, **AK ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e veta të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit duke e konsideruar këtë kërkesë të plotësuar.**

Neni 59 paragrafi 4 i LPP-së përcakton se një tender mund të konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse është në përputhshmëri me **të gjitha kërkesat e parashtruara në Njoftimin e Kontratës dhe në Dosjen e Tenderit.**

Andaj, meqenëse OE nuk e ka dëshmuar validitetin e marrëveshjes për 24 muaj apo deri në përfundimin e projektit, **AK është dashur ta konsiderojë ofertën të papërgjegjshme dhe jo ta trajtojë këtë kriter si të përmbushur.**

Kërkojmë që ky Pretendim të aprovohet si i bazuar,

Pretendimi Nr. 17

– Mini eskavator, 1 copë

Për pajisjen **Mini eskavator, 1 copë**, OE ka paraqitur marrëveshje me **Eteam Sh.p.k.**, të datës 24.06.2026, në të cilën deklarohet se pajisja jepet për realizimin e projektit.

Megjithatë, në këtë marrëveshje nuk përcaktohet afat validiteti prej 24 muajsh, dhe as nuk ekziston dispozitë që përcakton se marrëveshja do të mbetet valide deri në përfundimin e projektit apo gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

OE, pra, nuk ka dëshmuar se marrëveshja për Mini eskavatorin është valide për periudhën 24-mujore të kontratës, përkatësisht deri në përfundimin e projektit. Vetëm deklarimi se pajisja jepet “për realizimin e projektit” nuk përcakton afatin e vlefshmërisë së marrëveshjes dhe nuk garanton disponueshmërinë e saj deri në përfundimin e kontratës.

Pavarësisht kësaj mangësie, AK e ka konsideruar OE-në të përgjegjshëm, ndonëse kërkesa për validitetin e marrëveshjes ka qenë kërkesë e përcaktuar paraprakisht në dokumentet e tenderimit.

Kjo bie ndesh me nenin 59.4 të LPP-së, sipas të cilit tenderi konsiderohet i përgjegjshëm vetëm nëse është në pajtim me të gjitha kërkesat e Njoftimit për Kontratë dhe të Dosjes së Tenderit.

Për më tepër, neni 60 i LPP-së parasheh që kontrata t'i jepet operatorit ekonomik që ka dorëzuar tender të përgjegjshëm.

Andaj, përderisa OE nuk e ka plotësuar kërkesën konkrete lidhur me validitetin 24-mujor të marrëveshjes për Mini eskavatorin, **AK është dashur ta konstatojë mosplotësimin e kriterit dhe ta shpallë tenderin të papërgjegjshëm.**

Kërkojmë që ky Pretendim të aprovohet si i bazuar,

Pretendimi Nr. 18

– Pajisjet/makineria e siguruar përmes KOREKT COMPANY LLC

OE ka paraqitur marrëveshje me **KOREKT COMPANY LLC**, me të cilën makineria i jepet AGE group Sh.p.k. në shfrytëzim për realizimin e projektit.

Edhe në këtë marrëveshje nuk përcaktohet validitet prej 24 muajsh, dhe as nuk është përcaktuar se ajo do të mbetet valide deri në përfundimin e projektit apo gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

OE, rrjedhimisht, nuk ka dëshmuar se marrëveshja për pajisjen në fjalë është valide për periudhën 24-mujore të kontratës, përkatësisht deri në përfundimin e projektit. Formulimi se makineria jepet për realizimin e projektit përcakton vetëm destinimin e përdorimit të saj dhe jo afatin e vlefshmërisë së marrëveshjes.

Në këtë mënyrë nuk është dëshmuar se pajisja do të jetë në dispozicion të OE-së gjatë gjithë periudhës për të cilën AK ka kërkuar disponueshmërinë e saj.

Meqenëse kjo kërkesë ka qenë pjesë e kriterëve të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit, AK nuk ka pasur bazë që ta konsiderojë atë të plotësuar në mungesë

të dëshmisë së kërkuar.

Sipas nenit 59.4 të LPP-së, AK mund ta konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm kur ai përputhet me kërkesat e parashtruara në Njoftimin e Kontratës dhe në Dosjen e Tenderit.

Prandaj, duke e konsideruar ofertën të përgjegjshme pavarësisht mosplotësimit të këtij kriteri, **AK ka bërë vlerësim në kundërshtim me kërkesat që vetë i ka përcaktuar dhe me nenin 59.4 të LPP-së.**

Për më tepër, neni 60 i LPP-së parasheh që kontrata t'i jepet operatorit ekonomik që ka dorëzuar **tender të përgjegjshëm.**

Andaj, përderisa OE nuk e ka plotësuar kërkesën konkrete lidhur me validitetin 24-mujor të marrëveshjes për Mini eskavatorin, **AK është dashur ta konstatojë mosplotësimin e kriterit dhe ta shpallë tenderin të papërgjegjshëm.**

Kërkojmë që ky Pretendim të aprovohet si i bazuar,

Pretendimi Nr. 19

Shkelja e Nenit 1 të LPP-së – përdorimi joefikas i fondeve publike

Neni 1 i LPP-së kërkon shfrytëzim **efikas, transparent dhe ekonomik të fondeve publike.**

Në rastin konkret, oferta e **AGE GROUP SH.P.K. është 274,418.00 € me TVSH**, ndërsa oferta e **Hajrush Shoshi B.I. & NNP CTA SH.P.K. është 253,065.50 € me TVSH**, pra AGE GROUP është **21,352.50 € më e shtrenjtë**, ose rreth **8.44% më e lartë.**

Prandaj, nëse oferta e Hajrush Shoshit rezulton e përgjegjshme dhe elimini i saj ka qenë i kundërligjshëm, përzgjedhja e AGE GROUP e ekspozon buxhetin publik ndaj një **shpenzimi shtesë prej 21,352.50 €**, në kundërshtim me qëllimin e Nenit 1 të LPP-së për përdorim ekonomik dhe efikas të parasë publike.

Pretendimi Nr. 20

– Valon Kadiri nuk figuron në listat e stafit të deklaruar nga OE

Autoriteti Kontraktues në **Kërkesën 7 të Dosjes së Tenderit** ka kërkuar që OE të ketë së paku 10 punëtorë/staf, si dhe stafin përkatës profesional e teknik të kërkuar për realizimin e kontratës.

OE AGE Group Sh.p.k. ka paraqitur dokumentacion për **Valon Kadirin**, i cili në kontratën e punës figuron me profesion **“Mjeshtër i drenazhimit”**, me kontratë të lidhur për projektin konkret dhe me validitet deri në përfundimin e projektit. Për të është paraqitur edhe certifikatë trajnimi për sistemet e drenazhimit.

Mirëpo, nga verifikimi i **Listës së numrit të punëtorëve** të dorëzuar nga vetë OE rezulton se Valon Kadiri **nuk figuron në mesin e 10 punëtorëve të deklaruar**. Në këtë listë figurojnë Tahir Bala, Edvin Dema, Muhamed Hajda, Diona Bala, Roberto Denis Bala, Sulejman Deliu, Safedin Hamza, Valentina Shehu, Gezime Bala dhe Egzon Bala.



AK: KUVENDI KOMUNAL MITROVICË

NGA: AGE group SH.P.K

Data: 26.06.2026

Titulli: Rregullimi i Qendrës së Kulturës Aneksi A&B (LOT 1): Rregullimi i nyjeve sanitare në Qendrën e Kulturës, Palestrën Sportive dhe në Muzeun e Gjetitit (LOT 2)

Nr i Prok: 442-26-4255-5-2-1

Lista e Stafit profesional dhe Teknik

1. Titull i Pozites Ing i Ndërlmrtarisë drejtimi Konstruktive (Menaxher Projekti) Emri dhe Mblemri: Emal Hoxha
2. Titull i Pozites Ing i Arkitekturës Emri dhe Mblemri: Qazim Bytyqi
3. Titull i Pozites Inxhinier i Elektros Emri dhe Mblemri : Bujar Gjocaj
4. Titull i Pozites Inxhinier i Elektros Emri dhe Mblemri : Valon Jaha
5. Titull i Pozites : Inxhinier i Hidroteknikë per sistemet e ngrohjes dhe ftohjes Emri dhe Mblemri : Gani Balaj
6. Titull i Pozites : Ekspert per shendet dhe siguri ne Pune Emri dhe Mblemri : Muhamet Hamiti



7. Titull i Pozites : Teknik i Elektros Elektricit Emri dhe Mblemri : Ruzhdi Bytyqi
8. Titull i Pozites : Punetor per Siguri dhe Shendet ne Pune Emri dhe Mblemri : Bushra Hashani

"AGE group" Sh.p.k



Nr.	Emri dhe Mbiemri	Profesioni	Mosha	Eksperiencia	Pozita ne Ndermarrije
1	Tahir Bala	Mjeshter Hidroinstalues	54	27vite	Drejtor,ligjor
2	Edvin Dema	Mjeshter Keramist	33	6vite	Punetor
3	Muhamed Hajda	Mjeshter	31	10vite	Punetor
4	Diona Bala	Specialiste e Termozolimeve dhe	23	3vite	Punetor
5	Roberto Denis Bala	Moler	26	7vite	Menaxher
6	Sulejman Deliu	Punetor	33	8vite	Punetor
7	Safedin Hamza	Punetor	54	16vite	Punetor
8	Valentina Shehu	Punetor	24	6vite	Punetor
9	Gezime Bala	Punetor	49	15vite	Administratore
10	Egzon Bala	Punetor	30	8vite	Punetor

'Sh.p.k" AGE group Rahovec




Po ashtu, Valon Kadiri **nuk figuron as në “Listën e Stafit profesional dhe Teknik”** të dorëzuar nga AGE Group Sh.p.k. Në këtë listë OE ka deklaruar Ermal Hoxha, Qazim Bytyqi, Bujar Gjocaj, Valon Jahaj, Gani Balaj, Muhamet Hamiti, Ruzhdi Bytyqi dhe Bushra Hashani.

Pra, OE ka paraqitur kontratë dhe certifikatë për Valon Kadirin si person të angazhuar për realizimin e projektit, ndërsa **i njëjti nuk është përfshirë në asnjërën nga listat e stafit të deklaruar nga OE.**

AK, duke e pranuar Valon Kadirin për përmbushjen e kërkesës për staf, përkundër faktit se ai nuk figuron as në listën e 10 punëtorëve dhe as në Listën e Stafit profesional dhe Teknik, **nuk ka bërë vlerësimin në përputhje me dokumentacionin e deklaruar nga vetë OE dhe me kërkesat e përcaktuara në DT dhe Njoftimin për Kontratë.**

Nuk mund të konsiderohet një person si pjesë e stafit të deklaruar për përmbushjen e një kriteri, ndërkohë që OE nuk e ka përfshirë atë në listat përkatëse të stafit të dorëzuara në ofertë.

Andaj, konsiderojmë se OE nuk e ka dëshmuar plotësimin e Kërkesës 7 në mënyrën e kërkuar nga DT, ndërsa AK është dashur ta konstatojë këtë mospërputhje gjatë vlerësimit

dhe, në mungesë të përmbushjes së kriterit, ta trajtojë ofertën si të papërgjegjshme.

Kërkojmë që ky Pretendim të aprovohet si i bazuar,

Pretendimi Nr. 21

– Kaç Ahmeti nuk figuron në listat e stafit të deklaruar nga OE

*OE AGE Group Sh.p.k. ka paraqitur **Kaç Ahmetin** për pozitën profesionale të **Suvatuesit**.*

*Nga kontrata e punës rezulton se Kaç Ahmeti është i punësuar nga AGE Group Sh.p.k. me profesion “**Suvatues**”, me kontratë pune për periudhë të pacaktuar, me fillim nga data 01.01.2026.*

*Mirëpo, nga **Lista e numrit të punëtorëve** rezulton se Kaç Ahmeti **nuk është pjesë e 10 punëtorëve të deklaruar nga OE**. Lista përmban 10 persona të tjerë dhe emri i tij nuk figuron në të.*

*Gjithashtu, Kaç Ahmeti **nuk figuron as në Listën e Stafit profesional dhe Teknik** të dorëzuar nga AGE Group Sh.p.k. Edhe kjo listë përmban persona të tjerë dhe nuk e përfshin Kaç Ahmetin.*

*Kjo është veçanërisht relevante për faktin se Kërkesa 7 përcakton se OE duhet të ketë së paku 10 punëtorë/staf dhe më pas kërkon që “**së paku një (1) prej tyre**” të posedojë kualifikimin profesional të kërkuar.*

*Në rastin konkret, Kaç Ahmeti është paraqitur për të dëshmuar pozitën e Suvatuesit, mirëpo **nuk është përfshirë në asnjërën nga listat me të cilat OE ka deklaruar stafin e vet dhe puntort**.*

*AK ka konsideruar të plotësuar kërkesën për staf, ndonëse personi i paraqitur nga OE për pozitën e Suvatuesit **nuk figuron as në listën e 10 punëtorëve dhe as në Listën e Stafit profesional dhe Teknik**.*

*Nëse DT kërkon që personi me kualifikimin përkatës të jetë “**një prej tyre**”, atëherë një person që nuk është përfshirë fare në listën e stafit të deklaruar nuk mund të konsiderohet automatikisht si pjesë e këtij stafi.*

Andaj, duke e pranuar Kaç Ahmetin për përmbushjen e Kërkesës 7 përkundër mospërfshirjes së tij në listat e stafit të deklaruar as listen e puntorve, AK ka bërë vlerësim në kundërshtim me kërkesat e DT-së dhe Njoftimit për Kontratë. Për rrjedhojë, AK është dashur ta konstatojë mosplotësimin e kriterit dhe ta trajtojë ofertën e OE-së si të papërgjegjshme në raport me këtë kërkesë.

Kërkojmë që ky Pretendim të aprovohet si i bazuar,

KUNDËRSHTIM I ARSYETIMIT TË VENDIMIT TË AUTORITETIT KONTRAKTUES

*Aktiviteti i prokurimit: “Rregullimi i Qendrës së Kulturës Aneksi A&B (LLOT 1)”
Nr. i prokurimit: 642-26-4255-5-2-1*

Ankues: GOE Hajrush J. Shoshi B.I. – NNP CTA SH.P.K. – INTERING CONSTRUCTION SH.P.K.

Vendimi i kundërshtuar: Vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës 04.09.2026

Autoriteti Kontraktues ka refuzuar në tërësi Kërkesën për Rishqyrtim dhe ka vendosur të vazhdojë me Njoftimin mbi Vendimin e datës 27.08.2026. Në arsyetim AK deklaroi në mënyrë të përgjithshme se pretendimet nuk paraqesin bazë faktike apo juridike për ndryshimin e vendimit dhe se dokumentacioni duhet të vlerësohet në tërësi.

Mirëpo, shqyrtimi individual i pretendimeve tregon se në disa raste AK **nuk e konteston faktin e ngritur**, por e refuzon pretendimin për arsye të tjera; në raste të tjera nuk identifikon provën konkrete mbi të cilën mbështet përfundimin; ndërsa në raport me ofertën e AGE GROUP SH.P.K. përdor një standard dukshëm më fleksibil të vlerësimit sesa standardi i përdorur për eliminimin e GOE-së ankues.

PRETENDIMI NR. 1

Inxhinieri i Elektroteknikës i IDEALI COMPANY SH.P.K.

AK e refuzon këtë pretendim duke arsyetuar se ankuesi vetë pajtohet me konstatimin e AK-së se IDEALI COMPANY SH.P.K. nuk e ka përmbushur Kërkesën nr. 3 dhe se personi i propozuar ka profil “Elektronikë”, jo profilin e kërkuar sipas DT-së.

Kundërpërgjigjja: Pikërisht ky ka qenë qëllimi i pretendimit. Ankuesi nuk ka kërkuar ndryshimin e konstatimit të AK-së në favor të IDEALI COMPANY SH.P.K., por **ruajtjen në fuqi të konstatimit të papërgjegjshmërisë së këtij OE**. Në kërkesën tonë është argumentuar se pranimi i profilit “Elektronikë” si zëvendësim i drejtimit “Energjetikë”, pa qenë një barasvlerë e paraparë në DT, do të ndryshonte kriterin pas afatit të tenderimit.

Prandaj, nëse AK pajtohet me substancën e pretendimit, ai nuk mund të cilësohet njëkohësisht **“i pabazuar”**. Së paku AK është dashur ta konstatojë se argumenti është në pajtim me vlerësimin e saj dhe se konstatimi për papërgjegjshmërinë e IDEALI COMPANY SH.P.K. mbetet në fuqi.

PRETENDIMI NR. 2

– Inxhinieri i Hidroteknikës dhe certifikata e trajnimit

AK konstaton se mungesa e certifikatës për sistemet e ngrohjes dhe ftohjes është mangësi reale dhe se kërkesa ka qenë e përcaktuar paraprakisht në DT, por megjithatë pretendimin tonë e **“refuzon si të pabazuar”**.

Kundërpërgjigjja: Edhe këtu ekziston kundërthënie ndërmjet arsyesimit dhe dispozitivit për pretendimin. Kërkesa jonë pikërisht ka argumentuar se Kërkesa nr. 5 kërkonte jo vetëm inxhinier të Hidroteknikës, por edhe certifikatën konkrete të trajnimit për sistemet e ngrohjes dhe ftohjes, përfshirë teknologjinë e kontrollit.

Nëse AK konfirmon të njëjtin fakt dhe të njëjtën pasojë juridike, pretendimi nuk është **“i pabazuar”**; ai përforcon arsyen ekzistuese për papërgjegjshmërinë e IDEALI COMPANY SH.P.K.

PRETENDIMI NR. 3

– Kamera inspektuese e IDEALI COMPANY SH.P.K.

AK përsëri konfirmon se kërkesa për kamerën inspektuese 23 mm me kablllo 30 m ka qenë specifike dhe se OE nuk mund ta zëvendësojë atë me interpretim tjetër, por pretendimin e refuzon.

Kundërpërgjigjja: Kjo është pikërisht përmbajtja e pretendimit tonë. Kërkesa jonë ka argumentuar se pajisja është kërkuar me karakteristika konkrete dhe se mungesa e saj përbën mospërmbushje të kriterit teknik.

Prandaj, edhe në këtë pikë, AK faktikisht pajtohet me pretendimin, ndërsa konkluzioni “pretendimi refuzohet si i pabazuar” nuk përputhet me arsyetimin paraparak.

PRETENDIMI NR. 4

– Kamioneta me vinç e IDEALI COMPANY: 824 kg kundrejt maksimumit 600 kg

Në kërkesën tonë është paraqitur një mospërputhje e matshme: kërkesa e AK-së ka qenë “deri në 600 kg”, ndërsa në Certifikatën e Regjistrimit të pajisjes së IDEALI COMPANY SH.P.K. figuron vlera **824 kg**.

AK nuk e mohon këtë fakt. Në vend të kësaj, thotë se edhe sikur të kishte mospërputhje, ajo nuk do ta ndryshonte rezultatin, sepse IDEALI COMPANY tashmë ishte shpallur i papërgjegjshëm për arsye të tjera.

Kundërpërgjigjja: Ky arsyetim nuk i përgjigjet meritës së pretendimit. Çështja e ngritur ishte nëse **vlerësimi i ofertës është bërë i plotë dhe në pajtim me kriteret e DT-së**. Fakti që ekziston një arsye tjetër eliminimi nuk e eliminon detyrimin e AK-së që të vlerësojë në mënyrë të njëjtë dhe konsistente të gjitha kërkesat.

Për më tepër, AK nuk thotë se 824 kg plotëson kërkesën prej maksimum 600 kg. Pra, mospërputhja faktike mbetet e pakundërshtuar.

PRETENDIMI NR. 5

– Sekreti afarist dhe qasja në dokumentet e IDEALI COMPANY

Kërkesa jonë ka treguar se në listën e dokumenteve të ofertës figurojnë Deklaratat Tatimore dhe Raportet e Auditimit, por **nuk figuron Aneksi nr. 3 – Kërkesa për Sekret Afarist**.

AK përgjigjet se fakti që dokumentet nuk i janë dhënë palës së interesuar nuk provon vetvetiu shkelje dhe se duhet marrë parasysh natyra e informatës dhe kufizimet ligjore.

Kundërpërgjigjja: Ky arsyetim e anashkalon çështjen kryesore. Ne nuk kemi pretenduar vetëm se “nuk na janë dhënë dokumentet”, por se **nga dokumentacioni i ofertës nuk rezulton kërkesa konkrete për sekret afarist sipas Aneksit nr. 3**.

AK nuk ka identifikuar:

- se cili Aneks nr. 3 është paraqitur;
- cilat dokumente janë identifikuar në të;
- cilat informata janë kërkuar të mbrohen;
- dhe cili është arsyetimi konkret për dëmin material.

Prandaj, nuk është dhënë përgjigje konkrete mbi ligjshmërinë e vetë klasifikimit.

PRETENDIMI NR. 6

– Lista e kontratave të realizuara e IDEALI COMPANY

AK thotë se ekzistenca e mospërputhjeve ndërmjet dokumenteve nuk do të thotë automatikisht se kriteri nuk është përmbushur dhe se dokumentacioni duhet vlerësuar në tërësi.

Kundërpërgjigjja: Ne nuk kemi kërkuar që çdo dallim formal të rezultojë automatikisht në eliminim. Kemi identifikuar mospërputhje **materiale dhe të matshme**, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në vlerën dhe periudhën e kontratave që mund të llogariten.

Për shembull, janë identifikuar:

- kontrata ku data e përfundimit figuron dhjetor 2022 ose shkurt 2023;
- kontrata ku një dokument tregon rreth 20,888 €, ndërsa referenca 23,813.50 €;
- transaksione financiare që nuk arrijnë shumën e deklaruar në referencë.

AK nuk ka bërë llogaritjen konkrete se **sa është vlera e kontratave të pranueshme pas eliminimit të mospërputhjeve**. Pa këtë analizë nuk mund të konstatohet në mënyrë të arsyetuar se kriteri është plotësuar.

PRETENDIMET NDAJ ELIMINIMIT TË GOE-së HAJRUSH J SHOSHI BI NNP CTA SHPK DHE INTERING CONSTRUCTION

– Eliminimi i pabazuar lidhur me përvojën e Liderit dhe moskërkimi i sqarimit

Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar pretendimin tonë duke u mbështetur kryesisht në faktin se në Aneksin 6 është deklaruar vlera prej **234,500.00 €**, ndërsa pagesa e shumës shtesë prej **16,500.00 €** është realizuar më **25.08.2026**, pra pas afatit të dorëzimit të tenderëve. Mbi këtë bazë, AK e ka trajtuar dokumentacionin plotësues sikur me të synohet krijimi retroaktiv i përvojës së Liderit.

Kundërpërgjigjja:

Ky arsyetim bazohet në një ngatërrim ndërmjet **momentit të realizimit dhe faturimit të punëve dhe momentit të pagesës së faturës**.

Në rastin konkret, nuk është pretenduar se pagesa e datës 25.08.2026 krijon përvojë të re. Përvoja e Liderit lidhet me të njëjtin projekt të deklaruar në ofertë, përkatësisht **“Ndërtimi i Sallës së Sporteve në Vrellë – Vazhdim”**, dhe jo me një kontratë, projekt apo punë të re të paraqitur pas afatit. Dokumentacioni i paraqitur tregon se punimet e këtij projekti janë

faturuar përmes tetë faturave/situacioneve, me vlerë të përgjithshme **251,000.00 €**.

Në Aneksin 6 është shënuar vlera **234,500.00 €**, e cila përputhet saktësisht me shumën e shtatë faturave të para. Diferenca prej **16,500.00 €** nuk është e paidentifikueshme dhe as nuk lidhet me një realizim të ri; ajo i korrespondon saktësisht **Faturës nr. 13/2025, datë 01.12.2025, me përshkrimin “Fatura 8 sipas situacionit”**.

Rrjedhimisht:

$$234,500.00 \text{ €} + 16,500.00 \text{ €} = 251,000.00 \text{ €}$$

dhe Lideri e tejkalon minimumin e kërkuar prej **240,000.00 €** me **11,000.00 €**.

Rëndësia e Faturës nr. 13/2025 nuk mbështetet vetëm në një dokument unilateral të Liderit. E njëjta faturë është evidentuar në mënyrë reciproke dhe të përputhshme në dokumentacionin e të dy palëve:

- në **Librin e Shitjeve të Hajrush J. Shoshi B.I.**;
- në **Librin e Blerjeve të NNP CTA SH.P.K.**;
- me numrin e njëjtë **13/2025**;
- me datën e njëjtë **01.12.2025**;
- me bazën tatimore **13,983.05 €**;
- me TVSH **2,516.95 €**;
- dhe me vlerën totale **16,500.00 €**.

Kjo përputhje e plotë ndërmjet dy regjistrave reciproke përbën një gjurmë dokumentare objektivisht të verifikueshme dhe dëshmon se Fatura nr. 13/2025 **ka ekzistuar në vitin 2025**, shumë përpara afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve, i cili ka qenë më **26.06.2026**.

Për këtë arsye, pagesa e datës **25.08.2026** nuk mund të përdoret nga AK si argument se përvoja është krijuar pas afatit. Vetë kërkesa jonë ka sqaruar se kjo pagesë është përdorur vetëm si **provë korroboruese e shlyerjes së një detyrimi të krijuar dhe faturuar më 01.12.2025**. Zinxhiri dokumentar është: realizimi i punimeve → situacioni nr. 8 → Fatura nr. 13/2025 më 01.12.2025 → regjistrimi në Librin e Shitjeve → regjistrimi reciprok në Librin e Blerjeve → pagesa e mëvonshme e faturës.

Pra, data e pagesës nuk është data e krijimit të përvojës.

Çështja vendimtare që AK nuk e ka trajtuar është:

A ka ekzistuar para afatit të tenderimit realizimi, situacioni dhe Fatura nr. 13/2025, dhe a mund të verifikohet objektivisht ky realizim?

Dokumentacioni i paraqitur tregon se përgjigjja është po.

Në këto rrethana, AK nuk është dashur ta trajtojë shumën prej 234,500.00 € në Aneksin 6 si provë përfundimtare se Lideri nuk e plotëson kriterin. Ekzistonte një mospërputhje konkrete ndërmjet vlerës së shënuar në Aneksin 6 dhe dokumentacionit të realizimit, por kjo mospërputhje ishte **e identifikueshme, e sqarueshme dhe objektivisht e verifikueshme**.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme edhe në raport me vetë Dosjen e Tenderit. Neni 28.1 i saj përcakton se AK mund të kërkojë sqarim apo plotësim të dokumenteve dhe se sigurimi i

informacionit që mungon lejohet për dokumentet **ekzistenca e të cilave është e fiksuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve dhe mund të verifikohet objektivisht.**

Në rastin konkret këto kushte plotësohen:

- nuk ndryshohet Lideri;
- nuk ndryshohet përbërja e GOE-së;
- nuk shtohet kontratë e re;
- nuk shtohet projekt i ri;
- nuk shtohen punime të reja;
- nuk ndryshohet çmimi i tenderit;
- nuk krijohet përvojë pas afatit;
- verifikohet vetëm **vlera reale e realizimit të të njëjtit projekt të deklaruar në ofertë.**

Prandaj, sqarimi i Faturës nr. 13/2025 nuk do ta ndryshonte materialisht tenderin. Ai do të shërbente vetëm për të verifikuar një gjendje faktike që kishte ekzistuar përpara datës 26.06.2026.

Për më tepër, nëse AK kishte dyshim lidhur me autenticitetin e faturës apo evidentimin e saj tatimor, ekzistonte mundësia që të kërkonte verifikimin e saj përmes regjistrimeve përkatëse, pasi i njëjti transaksion rezulton në mënyrë reciproke të shitësi dhe blerësi. Kërkesa jonë e ka propozuar shprehimisht edhe këtë mënyrë objektive verifikimi.

Përfundimisht, AK ka gabuar duke e trajtuar pagesën e vitit 2026 si element përcaktues për ekzistencën e përvojës. Përvoja dhe dokumentimi i saj lidhen me realizimin dhe faturimin e vitit 2025; pagesa e mëvonshme vetëm konfirmon shlyerjen e faturës. Fatura nr. 13/2025, regjistrimet reciproke në Librin e Shitjeve dhe Librin e Blerjeve dhe lidhja e saj me situacionin nr. 8 përbëjnë prova që ekzistonin para afatit të tenderimit dhe që mund të verifikoheshin objektivisht.

Andaj, elimini i GOE-së pa kërkuar sqarimin dhe verifikimin e kësaj mospërputhjeje është i pabazuar, dhe kërkojmë që Pretendimi nr. 7 të aprovohet si i bazuar

PRETENDIMI NR. 8

– Vlerësim i gabuar i gjendjes ekonomike dhe financiare të GOE-së

Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar pretendimin tonë duke u fokusuar në faktin se raportet e auditimit duhet të ishin dorëzuar si pjesë e ofertës dhe se dokumentacioni i mëvonshëm nuk mund të përdoret për të krijuar retroaktivisht përmbushjen e kriterit.

Kundërpërgjigjja:

Ky arsyetim nuk e trajton drejt gjendjen faktike të ofertës dhe as natyrën e dokumentacionit financiar të dorëzuar.

Së pari, në ofertën e GOE-së **nuk ka munguar dokumentacioni financiar për periudhën relevante**. Në ofertë është dorëzuar, ndër të tjera, **Deklarata Tatimore Vjetore e INTERING CONSTRUCTION SH.P.K. për vitin 2023**, së bashku me deklaratën e të hyrave dhe shpenzimeve, ku figurojnë të ardhura bruto prej **872,921.40 €**. Për vitin 2024 janë deklaruar **903,580.90 €**, ndërsa për vitin 2025 **629,637.42 €**, që japin një qarkullim të përgjithshëm prej

2,406,139.72 €.

Kjo është me rëndësi thelbësore, sepse **neni 68.1.5 i LPP-së i njeh shprehimisht Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës si një nga format e dëshmisë për gjendjen ekonomike dhe financiare të operatorit ekonomik.** Pra, Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në tender nuk mund të trajtohen si dokumente të parëndësishme ose sikur dokumentacioni financiar për vitin 2023 të mos ekzistonte fare.

Pikërisht për këtë arsye, konstatimi i AK-së se **“mungon viti 2023”** nuk përputhet me përmbajtjen faktike të ofertës. Nëse në ofertë është dorëzuar Deklarata Tatimore Vjetore për vitin 2023, AK nuk mund të barazojë mungesën eventuale të një dokumenti plotësues, siç është raporti i auditimit, me mungesën e tërësishme të dëshmisë financiare për atë vit.

Së dyti, kriteri ekonomik dhe financiar duhet të vlerësohet në raport me **Grupin e Operatorëve Ekonomikë si tërësi**, dhe jo vetëm ndaj një anëtari individual. Në kërkesën tonë është theksuar se GOE përbëhet nga Hajrush J. Shoshi B.I., NNP CTA SH.P.K. dhe INTERING CONSTRUCTION SH.P.K., dhe se kriteri prej **550,000.00 €** duhet të vlerësohet mbi kapacitetin e përgjithshëm të Grupit.

Në këtë kontekst, vetëm dokumentacioni tatimor i INTERING CONSTRUCTION SH.P.K. tregon qarkullim trevjeçar prej **2,406,139.72 €**, shumëfish mbi minimumin prej 550,000.00 €. Për më tepër, vetëm NNP CTA SH.P.K. për vitet 2023 dhe 2024 ka qarkullim të audituar prej **988,610.00 €**, pra **438,610.00 € mbi pragun minimal të kërkuar.**

Prandaj, këtu nuk kemi të bëjmë me një GOE që nuk posedonte kapacitetin ekonomik dhe financiar. Përkundrazi, dokumentacioni i ofertës dhe dokumentet financiare ekzistuese tregojnë se kapaciteti ekonomik **ka ekzistuar para afatit të dorëzimit të tenderëve dhe ka qenë dukshëm mbi minimumin e kërkuar.**

Së treti, edhe nëse AK ka konsideruar se përveç Deklaratave Tatimore Vjetore mungonte ndonjë raport auditimi i kërkuar nga Dosja e Tenderit, kjo do të përbënte **çështje të plotësisë së dokumentit dëshmuar**, jo mungesë të vetë kapacitetit financiar.

Kjo dallim është vendimtar:

Kapaciteti financiar ekzistonte; çështja eventuale ishte mënyra e plotë e dokumentimit të tij.

Raportet e auditimit për NNP CTA SH.P.K. për vitet 2022, 2023 dhe 2024 kanë ekzistuar para afatit të tenderimit dhe në kërkesën tonë është paraqitur edhe prova se këto dokumente ishin në posedim të kompanisë që më **18.12.2025.**

Për këtë arsye, nëse AK kishte dyshim mbi plotësinë e dokumentacionit financiar, duhej të shqyrtonte përdorimin e mekanizmit të sqarimit/kompletimit për dokumente ekzistenca e të cilave ishte e fiksuar para skadimit të afatit dhe mund të verifikohesh objektivisht. Kërkimi i tyre nuk do të krijonte qarkullim të ri dhe as kapacitet financiar të ri pas afatit; do të dokumentonte një gjendje ekonomike që kishte ekzistuar paraprakisht.

Po ashtu, vetë argumentimi ynë ka theksuar se neni 68.3 lejon që, në rrethana të caktuara, gjendja ekonomike dhe financiare të demonstrohet edhe përmes dokumentit tjetër të përshtatshëm, çka tregon se qëllimi i nenit 68 është **verifikimi real i kapacitetit ekonomik dhe financiar**, dhe jo eliminimi automatik për një mangësi dokumentare kur vetë kapaciteti

mund të verifikohet objektivisht.

Përfundimisht, AK ka bërë një barazim të gabuar ndërmjet:

- mungesës eventuale të një dokumenti plotësues, dhe
- mungesës së kapacitetit ekonomik dhe financiar.

Në rastin konkret, Deklaratat Tatimore Vjetore kanë qenë të dorëzuara dhe përbëjnë vetë një formë të njohur ligjore të dëshmisë sipas nenit 68 të LPP-së. Për më tepër, qarkullimi i dokumentuar i anëtarëve të Grupit tejkalon shumëfish minimumin prej 550,000.00 €. Prandaj, AK nuk ka pasur bazë ta trajtojë GOE-në sikur të mos kishte dëshmuar fare gjendjen ekonomike dhe financiare, pa e vlerësuar fillimisht dokumentacionin tatimor të dorëzuar dhe, nëse konsideronte se mungonte ndonjë dokument plotësues, pa shqyrtuar mundësinë e sqarimit të tij sipas dispozitave përkatëse.

Andaj, kërkojmë që ky pretendim të aprovohet si i bazuar dhe të konstatohet se vlerësimi i AK-së lidhur me gjendjen ekonomike dhe financiare të GOE-së është bërë në mënyrë jo të plotë dhe të gabuar.

PRETENDIMET NDAJ AGE GROUP SH.P.K.

PRETENDIMI NR. 9

– Kontrata e ekspertit për Siguri dhe Shëndet në Punë

AK thotë se fakti që në kontratë Muhamet Hamiti figuron si “Ekspert i certifikuar nga AME për mbrojtje nga zjarri” nuk përjashton që dokumentacioni tjetër të dëshmojë kualifikimin për Siguri dhe Shëndet në Punë.

Kundërpërgjigjja: Pretendimi ynë nuk konteston vetëm **kualifikimin**. Ai konteston **angazhimin kontraktual në pozitën e kërkuar**.

Certifikata mund të dëshmojë kualifikimin. Por AK kishte kërkuar veçmas edhe kontratë/parakontratë për angazhimin e personit. Kontrata e paraqitur e identifikon atë për një funksion tjetër profesional.

Prandaj AK duhet të identifikojë dokumentin konkret që dëshmon se personi është kontraktuar për pozitën e kërkuar, jo vetëm të thotë se “dokumentacioni në tërësi” është i mjaftueshëm.

PRETENDIMI NR. 10

– Minimumi 5 vite përvojë pas certifikimit

AK argumenton se pozita “Menaxher Ekzekutiv” nuk përjashton automatikisht mundësinë që Muhamet Hamiti të ketë kryer edhe detyra të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.

Kundërpërgjigjja: Çështja nuk është nëse kjo është **e mundshme**, por nëse është **e dëshmuar**.

Në dokumentacionin e analizuar në kërkesën tonë, referencat që e identifikojnë konkretisht si

Ekspert për Siguri dhe Shëndet në Punë dokumentojnë afërsisht **3 vite e 7 muaj**, jo 5 vite.

AK nuk ka identifikuar asnjë periudhë tjetër konkrete, me datë fillimi dhe mbarimi, që e çon përvojën profesionale të dokumentuar në minimumin prej pesë viteve.

Konstatimi se personi **mund të ketë kryer** detyra profesionale nuk është i njëjtë me provën se ai **i ka kryer** ato për periudhën e kërkuar.

PRETENDIMI NR. 11

– Mungesa e Aneksit nr. 7 – Lista e Pajisjeve

AK pranon se AGE GROUP nuk e ka dorëzuar Aneksin nr. 7 të plotësuar, por thotë se dokumentet individuale për pajisjet mjaftojnë dhe se forma e sistemit të dokumenteve nuk është mangësi materiale.

Kundërpërgjigjja: Këtu paraqitet qartë standardi i ndryshëm i aplikuar nga AK.

DT kishte kërkuar shprehimisht:

“Listë për pajisjet... sipas Aneksit 7.”

Në kërkesën tonë është theksuar se “Paisjet.pdf” përmbante dokumente individuale, por **jo Aneksin nr. 7 të plotësuar**.

Ne madje nuk kemi pretenduar se kjo duhet patjetër të rezultojë në eliminim të menjëhershëm. Kemi thënë se, nëse dokumentet e tjera mundësonin sqarimin, AK ishte dashur ta evidentonte mungesën dhe ta trajtonte atë në procedurën përkatëse të sqarimit.

Është kontradiktore që për AGE GROUP mungesa e një dokumenti të kërkuar shprehimisht të konsiderohet “formale”, ndërsa ndaj GOE-së sonë AK refuzon sqarimin e dokumenteve që, sipas pretendimeve tona, kanë ekzistuar para afatit.

PRETENDIMI NR. 12

– Kamioneta me lift, maksimum 850 kg

AK thotë se fakti që të dhënat janë redaktuar në kopjen e dhënë për qasje nuk provon se AK nuk i ka pasur të dhënat në versionin origjinal.

Kundërpërgjigjja: Pretendimi nuk ishte vetëm “ne nuk e shohim dokumentin”.

Pretendimi ishte:

1. nga versioni i dhënë për qasje nuk verifikohet parametri teknik 850 kg;
2. pikërisht rubrikat për masën/peshën janë redaktuar;
3. duhet verifikuar baza ligjore e klasifikimit të atyre të dhënave si sekret afarist.

Nëse AK ka parë dokumentin origjinal, duhet së paku të deklarojë **cila rubrikë dhe cila vlerë**

konkrete e kanë bindur se kriteri prej 850 kg është plotësuar.

Po ashtu, AK nuk identifikon Aneksin nr. 3 apo arsyetimin konkret mbi të cilin është bërë redaktimi.

PRETENDIMI NR. 13

– Kamioneta me vinç, deri në 600 kg

AK përgjigjet se në marrëveshje pajisja përshkruhet si kamionetë me vinç deri në 600 kg dhe se redaktimi i kopjes nuk zhvlerëson dokumentin origjinal.

Kundërpërgjigjja: Marrëveshja është deklaram i palëve. Kërkesa jonë ka ngritur pikërisht çështjen e **provës teknike objektive** nga Certifikata e Regjistrimit.

Nga dokumentacioni i qasjes rezulton vetëm se mjeti është “Kamionetë me vinç”, ndërsa rubrikat teknike F, F.1 dhe G janë të mbuluara.

AK nuk e identifikon vlerën konkrete të evidentuar në dokumentin origjinal. Pra, arsyetimi mbetet deklarativ: “e kemi parë”, pa treguar se çfarë është verifikuar.

PRETENDIMI NR. 14

– Mini-eskavatori: karakteristikat dhe identifikimi

AK thotë se dokumentacioni origjinal është vlerësuar dhe se pala nuk mund të kërkojë publikimin e çdo të dhëne nëse ajo është ligjërisht e mbrojtur.

Kundërpërgjigjja: Kërkesa jonë ka identifikuar dy probleme të ndryshme:

- karakteristika e pajisjes në marrëveshjen me ETEAM është e redaktuar;
- të dhënat identifikuese në DUD janë po ashtu të redaktuara, prandaj nuk mund të lidhet objektivisht pajisja në marrëveshje me pajisjen e importuar.

Vendimi nuk thotë se cili numër serik apo identifikues në dokumentin origjinal përputhet ndërmjet dokumenteve.

Po ashtu, shprehja “nëse këto të dhëna janë ligjërisht të mbrojtura” nuk është konstatim se **ato konkretisht janë klasifikuar ligjërisht.**

PRETENDIMI NR. 15

– Kamera inspektuese dhe numri serik

AK pranon se numri serik është element identifikues, por thotë se ankuesi nuk ka provuar që mungesa e tij në kopjen e pastruar ka penguar AK-në që ta verifikojë pajisjen.

Kundërpërgjigjja: Pikërisht kjo është çështja: pala e interesuar nuk mund të kontrollojë nëse AK ka bërë verifikimin korrekt, sepse është redaktuar elementi kryesor individualizues.

Në DUD përshkruhet kamerë 23 mm me kablo 30 m, por numri serik është mbuluar.

Kërkesa jonë ka kontestuar edhe bazën ligjore për sekretin afarist dhe ka kërkuar që të verifikohet nëse Aneksi nr. 3 e identifikon konkretisht numrin serik dhe arsyeton dëmin material.

Vendimi nuk jep përgjigje për këtë pjesë të pretendimit.

PRETENDIMI NR. 16

– Validiteti i marrëveshjes për kamionetën me vinç

AK argumenton se nuk është e domosdoshme që marrëveshja të përmbajë shprehjen identike “24 muaj”, sepse fakti që pajisja jepet për realizimin e projektit është i mjaftueshëm.

Kundërpërgjigjja: Problemi nuk është mungesa e fjalëve identike “24 muaj”, por mungesa e një afati juridikisht të përcaktueshëm.

Në marrëveshje thuhet se pajisja jepet për realizimin e projektit, por nuk thuhet:

- se marrëveshja është valide 24 muaj;
- se është valide deri në përfundim të kontratës;
- apo se mbetet në fuqi gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj.

Qëllimi i marrëveshjes dhe kohëzgjatja e marrëveshjes janë dy çështje të ndryshme.

Nëse DT ka kërkuar shprehimisht validitet për kohëzgjatjen e kontratës, AK nuk mund ta zëvendësojë këtë me një supozim se marrëveshja do të zgjasë aq sa projekti.

PRETENDIMI NR. 17

– Validiteti i marrëveshjes për mini-eskavatorin

AK përdor të njëjtin arsyetim: formulimi “për realizimin e projektit” duhet vlerësuar në tërësi dhe mungesa e fjalëve “24 muaj” nuk është automatikisht provë e mungesës së disponueshmërisë.

Kundërpërgjigjja: Edhe këtu AK e zhvendos çështjen.

Kërkesa nuk ishte që kontrata të përmbajë një “formulë magjike”, por që të dëshmohet ajo që DT ka kërkuar: **disponueshmëria për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës.**

Marrëveshja me ETEAM nuk përcakton as afat 24-mujor dhe as validitet deri në përfundimin e projektit.

AK nuk identifikon asnjë dispozitë tjetër të marrëveshjes nga e cila juridikisht rezulton kohëzgjatja 24-mujore.

PRETENDIMI NR. 18

– Pajisjet nga KOREKT COMPANY LLC

AK përsëri thotë se fakti që pajisja është vënë në dispozicion “për realizimin e projektit” është i mjaftueshëm dhe se ankuesi nuk ka provuar se AGE GROUP nuk do ta kishte pajisjen gjatë realizimit.

Kundërpërgjigjja: Ky arsyetim e përmbys barrën e provës.

*Nuk është ankuesi që duhet të provojë se AGE GROUP **nuk do ta ketë** pajisjen. OE duhet të dëshmojë se **do ta ketë në dispozicion për periudhën e kërkuar**, në mënyrën e përcaktuar në DT.*

Marrëveshja me KOREKT COMPANY LLC nuk përcakton 24 muaj dhe as validitet deri në përfundim të kontratës.

Prandaj AK është dashur të identifikojë provën pozitive të kohëzgjatjes, jo të kërkojë nga ankuesi të provojë të kundërtën.

PRETENDIMI NR. 19

– Çmimi 21,352.50 € më i lartë

AK thotë me të drejtë në parim se vetëm fakti që një ofertë është më e lirë nuk e bën atë automatikisht fituese nëse është e papërgjegjshme.

Kundërpërgjigjja: Por ky nuk ka qenë argumenti ynë.

*Pretendimi është shprehur në mënyrë **kushtore**: nëse eliminimi i GOE-së sonë është i kundërligjshëm dhe oferta jonë rezulton e përgjegjshme, atëherë përzgjedhja e ofertës së AGE GROUP prej 274,418 € në vend të ofertës sonë prej 253,065.50 € shkakton diferencë prej **21,352.50 €**, ose rreth 8.44%.*

Prandaj Pretendimi nr. 19 nuk mund të vlerësohet i izoluar nga Pretendimet nr. 7 dhe 8.

Nëse eliminimi ynë rrëzohet, atëherë pasoja ekonomike bëhet drejtpërdrejt relevante.

PRETENDIMI NR. 20

– Valon Kadiri nuk figuron në listat e stafit

AK thotë se fakti që personi nuk figuron në një listë nuk do të thotë automatikisht se ai nuk është i angazhuar, pasi kontrata e punës dhe certifikata e tij janë dëshmi relevante.

Kundërpërgjigjja: Pretendimi nuk ka qenë se Valon Kadiri “nuk ekziston” apo nuk ka kontratë.

*Pretendimi është se OE ka dorëzuar **lista konkrete të stafit të deklaruar**, ndërsa Valon Kadiri nuk figuron:*

- as në listën e 10 punëtorëve;
- as në Listën e Stafit Profesional dhe Teknik.

Nëse një person përdoret për përmbushjen e kriterit të stafit, AK duhet të shpjegojë në çfarë baze konsiderohet pjesë e stafit të deklaruar kur OE vetë nuk e ka përfshirë në asnjërën listë.

Thjesht cilësimi i listës si “administrative” nuk e zgjidh këtë mospërputhje.

PRETENDIMI NR. 21

– Kaç Ahmeti nuk figuron në listat e stafit

AK përdor të njëjtin argument dhe thotë se kontrolli nuk mund të reduktohet në emrin në një tabelë, sepse kontrata e punës dëshmon marrëdhënien e punës dhe profesionin.

Kundërpërgjigja: Për Kaç Ahmetin çështja është edhe më e drejtpërdrejtë.

Në kërkesën tonë është evidentuar se Kërkesa nr. 7 parasheh së paku 10 punëtorë/staf dhe më pas kërkon që “**së paku një (1) prej tyre**” të posedojë kualifikimin përkatës.

Kaç Ahmeti:

- nuk figuron në listën e 10 punëtorëve;
- nuk figuron në Listën e Stafit Profesional dhe Teknik;
- ndërsa përdoret për plotësimin e pozitës së Suvatuesit.

Nëse formulimi është “një prej tyre”, atëherë AK duhet të shpjegojë si mund të konsiderohet “një prej tyre” një person që nuk është përfshirë në grupin/listën të cilës i referohet kjo shprehje.

Vendimi nuk e trajton këtë argument tekstual të DT-së.

KUNDËRTHËNIA KRYESORE NË VENDIM

Në tërësi, Vendimi i AK-së paraqet një problem serioz të **standardit të dyfishtë në vlerësim**.

Ndaj GOE-së sonë, AK arsyeton se:

dokumentacioni duhet të jetë dorëzuar në ofertë dhe nuk mund të plotësohet më vonë për të përmbushur kriterin.

Ndërsa ndaj AGE GROUP:

- mungesa e Aneksit nr. 7 konsiderohet çështje forme;
- kontrata e ekspertit me profil tjetër vlerësohet së bashku me dokumentet e tjera;
- përvoja 5-vjeçare prezumohet nga tërësia e dokumenteve pa u identifikuar periudha konkrete;

- mungesa e afatit 24-mujor interpretohet nga “qëllimi i projektit”;
- personat që mungojnë në listat e stafit pranohen mbi bazën e kontratave individuale;
- parametrat teknikë të redaktuar konsiderohen të verifikuar vetëm sepse AK deklaroi se i ka parë origjinalet.

Ndërkohë, për GOE-në tonë, një faturë e datës 01.12.2025, e evidentuar reciprokisht në regjistrat e të dy kompanive, trajtohet si dokument “i mëvonshëm” kryesisht për shkak se pagesa është realizuar në vitin 2026. Dokumentacioni ynë e ndan shprehimisht realizimin/faturimin e vitit 2025 nga pagesa e mëvonshme.

Ky dallim në qasje është çështje që kërkon rivlerësim të plotë.

VENDIM

APROVOHET si e bazuar Ankesa e **OE HAJRUSH J. SHOSHI B.I. – UNIKU & INTERING CONSTRUCTION & NNP “CTA” SH.P.K** lidhur me tenderin **Rregullimi i Qendrës së Kulturës Aneksi A&B LLOT 1** me nrp: 642-26-4255-5-2-1

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e **Rregullimi i Qendrës së Kulturës Aneksi A&B LLOT 1** dhe lënda të kthehet në **RI-VLERËSIM**.

9. Dëmet materiale

Përshtetja mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkakuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, shpenzime përgatitore në aspektin teknik për kontratë. Po ashtu kemi edhe dëmtim të reputacionit si një kompani serioze, dhe me një përvojë të madhe në fushën e ndërtimeve.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Ne i kemi bashkangjitur Ankesës tonë dokumentet e renditura më poshtë:

- Një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë”
- Një kopje të publikimit për “Njoftimi mbi Vendimin e AK”
-

Vërejtje: Të gjitha pretendimet tona mbështeten me fakte që i gjeni të bashkangjitura kësaj anese por edhe në dokumentacionin e AK

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.